

BISMIL'LAHI'R-RAHMANI'R-RAHIM

LIBRI PËR FSHEHTËSITË E ZEKATIT

Ihjaw Ulumid-din
Ringjallja e diturive fetare
Imam Gazali

Titulli i origjinalit:
KITABU ESRARI'Z- ZEKAT
LIBRI 5

Përgatiti dhe përktheu:
Is-hak Shala dhe Abdullah B. Ferizi

Lektor:
Shenaj Zeneli

Me emrin e Allahut, Mëshiruesit, Mëshirëbërësit!

Hamd Allahut, ai Allah që jep bollëk dhe skamje, krijon e zhdukë, gëzon e pikëllon, varfëron e pasuron, jep dëmin e sjell dobinë, i Cili prej një pike uji e krijoi çdo gjallesë. Disa robëve të Tij ju dha bollëk, si sprovë dhe lehtësim, e ata që nuk mund të fitojnë i bëri nevojtarë të tyre. Më pas e bëri zekatin bazë të fesë dhe themelin e saj, dhe shpjegoi se si përmes tij pastrohen robët e Tij, dhe se kush e dhuron pasurinë, ajo vetëm sa i shtohet.

Salat dhe selam diellit të udhëzimit, zotërisë së njerëzimit, Muhammedit s.a.v.s., ehli bejtit, as'habëve të tij, që janë dalluar me dituri dhe devotshmëri (takva)!

Pas kësaj dije se Allahu Teala e bëri zekatin njërën prej shtyllave të islamit dhe në shumë ajete e përmendi bashkë me namazin:

"Faleni namazin dhe jepeni zekatin." 2-Bekare: 110,

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

"Islami është ngritur mbi pesë shtylla (parime themelore): dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër përvec Allahut dhe se Muhamedi (a.s.) është i dërguari i Tij, falja e namazit, dhënia e zekatit, shkuarja në haxh dhe agjërimi i Ramazanit."¹,

¹ Muttefekun alejhi

ndërsa atyre që nuk japin zekat, Allahu Teala ju drejton kërcënim të rreptë:

“Ata që e grumbullojnë arin dhe argjendin dhe nuk e shpenzojnë në rrugën e Allahut (si janë urdhëruar), lajmëroi për një dënim të dhembshëm.” 9-Teube: 34

Ahnef ibn Kajs tregon:

*“Isha me disa nga Kurejshët. Erdhi Ebu Dherr, e na tha:
- Lajmëroni ata që mbledhin pasuri e nuk japin zekatin se me hekur të skuqur do të goditen në shpinë e do t’ju dalë në gjoks, do të goditen në zverk e do t’ju dalë në ball!”*

Në një verzion tjetër të këtij transmetimi thuhet se ata do të goditen në gjoks dhe në mes të shpatullave dhe do t’ju dalë flakë, dhe prapë do të goditen në mes të shpatullave që me drithërimë ju del nga gjoksi.

Ebu Dherr tregon: *“Iu afrova Resulallahut, s.a.v.s., që po rrinte ulur në hijen e Qabes. Kur më pa, më tha:*

- Pasha Rabbin e Qabes, ata më së shumti janë shkatërruar!

- Kush janë ata?, pyeta unë, e tha:

- Ata që kanë më së shumti pasuri, përpos artyre që jepen para vetes, pas vetes, djathtas vetes dhe majtas vetes (pra, ai që jep në të gjitha anët), e të atillë ka pak.

Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

”Secili pronar i deveve, lopëve dhe dheneve i cili nuk e jep zekatin për to, në ditën e gjykimit ajo kafshë do ti bëhet shumë më e madhe se që ka qenë dhe do ta shpojë me brirë e do ta shkelë me thundra, e pasi të përfundojë njëra i kthehet tjetra, deri sa të gjykohen të gjithë njerëzit.”²

Nëse një hadith i këtillë është i shënuar në dy përmbledhjet më të besueshme të hadithit (Buhari dhe Muslim), atëherë ndër çështjet më me rëndësi për fenë del të jetë edhe sqarimi i fshetësive të zekatit, kushteve të tij të qarta dhe të fshehura, si edhe kuptimeve të tij të dukshme e të padukshme, ku do të kufizohemi në atë që është e domosdoshme ta dijë dhuruesi i zekatit dhe marrësi i tij. Të gjitha këto do t’i paraqesim në katër kapituj;

² Muttefekun alejhi.

Kapitulli i parë

LLOJET E ZEKATIT DHE KUSHTET PËR OBLIGUESHMËRINË E TIJ

Zekati jepet për gjashtë gjëra:

1. Zekati për bagëtinë: deve, lopë, buall, dele e dhi;
2. Zekati i një të dhjetës;
3. Zekati për ari dhe argjend;
4. Zekati për mallin e tregtisë;
5. Zekati për thesaret e nëntokës e për minerale; dhe
6. Zekati fitr.

ZEKATI I BAGËTIVE

Ky lloj i zekatit, si edhe llojet tjera, i janë obligim vetëm myslimanit të lirë. Moshë e pjekur nuk është kusht, prandaj zekat ndahet edhe nga pasuria e fëmijës si edhe nga pasuria e të çmendurit. Ky është kushti për ata që janë të obliguar të japin zekat.³

³ Sipas medh'hebit Hanefi, zekati është farz për myslimanin e pasur, të lirë, mendërisht të shëndoshë dhe që ka arritur moshën e pjekurisë. I çmenduri kur shërohet dhe fëmiu kur arrin moshën e pjekurisë, fillojnë të japin zekatin.

Zekati i bagëtive i ka pesë kushte:

- 1) Zekati jepet për deve, lopë, buall, dele, dhi.
- 2) Kafshët të kullosin lirshëm
- 3) Ta ketë në pronësi për një vit të plotë.
- 4) Kafsha të arrijë vlerën e *nisabit* të plotë.
- 5) Të jetë në pronësi të plotë të pronarit.

Tani t'i shjegojmë këto kushte:

Kushti i parë: të jetë kafshë shtëpiake. Zekati jepet vetëm për deve, lopë, ka, buall, dele, dhi. Zekat nuk jepet për kalin, mushkën, gomarin, e as kur dhia e egër mbarështohet me dele.

Kushti i dytë: kafshët duhet të kullosin lirshëm, nëpër fusha, kullota të disponueshme, pjesën më të madhe të vitit, që do të thotë se zekati nuk jepet për kafshët që ushqehet brenda. Edhe nëse vetëm një pjesë të kohës janë të lira në kulloso, prapë nuk jepet zekat.

Kushti i tretë: të kalojë viti. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Zekati nuk jepet për diçka që nuk ka qenë në dorën tuaj për një vit.”⁴ Prandaj nga zekati përjashtohen kafshët e posalindura, e që llogariten si pronë për të cilat është obligim të jepet zekat pasi të kalojë një vit. Nëse gjatë vitit shet diçka nga bagëtia, llogaritja e vitit ndërpritet.

⁴ Ebu Davud, me zinxhir të mirë të transmetuesve.

Kushti i katërt: pronësia e plotë dhe e drejta e posedimit. Kështu, zekati është i obliguar edhe për bagëtinë e dhënë peng, sepse edhe ato janë edhe më tutje në pronë të tij, deri sa nuk ka obligim për bagëtinë e humbur ose të rrëmbyer, përpos nëse i kthehet, bashkë me pjellën e mundur. Në atë rast e ka obligim të japë zekat për gjithë kohën e kaluar, përpos nëse ka aq shumë borxhe sa do t'i harxhohej gjithë pasuria. Atëherë nuk do të mund të llogaritej si i pasur, sepse pasuri është ajo që i tejkalon nevojat.

Kushti i pestë: të përmbushet *nisab* i plotë (masa nën të cilën dhënia e zekatit nuk është obligim).

Nisabi i deveve:

Deri në pesë deve nuk ka zekat.

Prej 5 deve deri 9 deve jepet një dele dy vjeçare ose një dhi tri vjeçare.

Prej 10 deri 14 deve, dy dele.

Prej 15 deri 19 deve tri dele.

Prej 20 deri 24 deve katër dele.

Prej 25 deri 35 deve jepet një deve femër, dy vjeçare.

Prej 36 deri 45 deve, një deve tre vjeçare.

Prej 46 deri 60 deve, një deve katër vjeçare.

Prej 61 deve deri 75 deve, një deve pesë vjeçare.

Prej 76 deve deri 90 deve, dy deve tri vjeçare.

Prej 91 deri 120 deve, dy deve femra, katër vjeçare.

Prej 121 deri 130 deve, tri deve femra, tri vjeçare.

Prej 130 deve e më shumë, bëhet llogaria, ashtu që në çdo 40 deve jepet një deve tri-vjeçare, e në çdo 50 deve jepet një deve katër-vjeçare.

Nisabi i lopëve:

Deri në 29 lopë nuk ka zekat.

Prej 30 deri 39 lopë, jepet zekat një viç dy vjeçar.

Prej 40 deri 59, një viç tre vjeçar.

Prej 60 lopë, dy viça dy-vjeçarë.

Pas këtij numri, caktohet llogaria; në çdo 30 lopë, jepet një lopë dy-vjeçare, e në çdo 40 lopë jepet një lopë tri-vjeçare.

Nisabi i deleve:

Deri në 39 dele nuk ka zekat.

Prej 40 deri 120 dele, jepet zekat një dele dy-vjeçare, ose një dhi tri-vjeç.

Prej 121 deri 200, jepen dy dele.

Prej 201 deri 399, tri.

Prej 400 deri 449, katër.

Prej 500 deri 599, pesë, më tutje në çdo 100 jepet nga një dele.⁵

⁵ Sipas medh'hebit Hanefi, te delet dhe dhitë, nuk bëhet dallimi në moshë. Nëse posedon vetëm dhi, jep zekat dhi, e nëse posedon vetëm dele, jep dele. Nëse i posedon të dyja, jep ose dhi ose dele, si të dëshirojë.

Zekati i ortakëve është si zekati i një personi. Nëse njëri mes ortakëve nuk është *zimmi* (jo-mysliman nën mbrojtje të shtetit) ose *mukatib* (skllavi me marrëveshje për lirinë e vet), delet kullosin bashkërisht, bashkë pinë ujë, bashkë mjelen, bashkë ruhen, nëse bashkë i kanë katërdhjetë dele, jepin një dele bashkërisht. Bile nëse tre ortakë së bashku posedojnë njëqind e njëzet dele, përsëri për që të tre llogaritet një dele për zekat. Por nëse nga ortakët njëri është *zimmi* atëherë myslimani nëse ka hise katërdhjetë dele, jep zekat një dele, e nëse nuk i ka aq, nuk jep.

Sa për deve, nëse nuk posedon deve katër vjeçare, për zekat mund të japë deve tre ose dy vjeçare; por jo më të re se dy vjeçare, dhe e paguan dallimin në moshë. Shembull; nëse jep deve një vit më të re, obligimin e plotëson me dy dele ose njëzet dërhëmë shtesë, e për dy vite (më të re) katër dele ose katërdhjetë dërhëmë.

Gjithashtu, për zekat mund të jepet edhe deveja më e vjetër se sa është caktuar, nëse nuk i kalon pesë vite. Në atë rast dhuruesit i kompenzohet dallimi nga arka e shtetit. Për zekat nuk merret kafsha e sëmurë, nëse ka të shëndosha, qoftë edhe një. Nga kafshët me cilësi të mirë merret e mira, e nga ato me cilësi të dobët merret kafshë e dobët.

Për zekat nuk merret kafsha e caktuar për therrje, as kafsha shterpe, as delja e sapolindur, as bagëti mashkull, as bagëtia më e mirë. Pra, nëpunësi i pushtetit që e tubon zekatin nuk mund të zgjedh më të miren e ta marrë për zekat.

ZEKATI I NJË TË DHJETËS (PËR PEMË, PERIME DHE PRODUKTE BULQËSORE)

Për bimët ushqimore që arrijnë shumën prej tetëqind *menna*⁶ duhet dhënë zekat, e nëse janë më pak se kaq nuk i nënshtrohen obligimit. Zekat nuk jepet për pemë e pambuk, por jepet për drithëra ushqimore, për hurme të thata dhe rrush të terun. Hurme dhe rrush të terun duhet të ketë së paku tetëqind *menna*, por hurmet e freskëta dhe rrushi i zakonshëm nuk llogariten. Zekati për to ndahet pas tharjes ku përfshihet edhe prona e ortakut, si te kopshti i përbashkët ndër trashëgimtarët, ku sasia e përbashkët duhet të jetë së paku tetëqind *menna*, përshtatshëm hiseve individuale. Nuk është e mundur që *nisabi* për grurë të paguhet me elb, derisa *nisabi* i elbit mund të paguhet me tërshërë, sepse llogaritet i llojit të njëjtë.

⁶ 1 *menn* = 2 *ratl*. 2 *ratl* = 144 dërhemë; në Bejrut dhe Haleb = 2.566 kilogramë.

Kjo masë, pra 10% nga të ardhurat totale është obligim për prodhimet që ujiten me shi ose me ujë me rredhje të vazhdueshme, deri sa në prodhime që ujiten me dorën e njeriut jepet gjysma e kësaj, pra 5%. Nëse ujiten në të dy mënyrat, llogaritet ajo që është më e shpeshtë. Te hurmat e thata dhe rrushin e terun, masa merret pas vjeljes, deri sa vet hurmat dhe rrushin nuk merren deri sa të jenë pjekur plotësisht, pos në rastin kur pemishten e godet ndonjë epidemi, e atëherë vjelja bëhet edhe para pjekjes së plotë.

9/10 e hurmeve i lihen pronarit, e 1/10 u ndahet fukarave, sepse diçka e tillë lejohet kur është nevoja. Zekati bëhet obligim kur frutat e drithërat të piqen, ndërsa koha e dhënies së zekatit nis pasi që ato të jenë tharë.

ZEKATI NË ARI DHE ARGJEND

Kur argjend i pastër në vlerë prej 200 dirhemë⁷ sipas matjes mekase qëndron te një person për një vit, në atë vlerë jepen 5 dërhëmë, pra, 2,5%. Gjithçka përtej kësaj, goftë edhe një dërhëm, duhet llogaritur.

⁷ 200 dërhëmë është 641,46 gramë.

Nisabi i arit është 20 *miskalë*⁸ të pastër, sipas matjes mekase, (kësaj i thuhet edhe 20 dinarë, sepse një dinar është një miskal).

Në atë shumë ndahet çereku i dhjetëshes, pra 2.5%, e gjithçka që e tejkalon nisabin, duhet llogaritur. Por, nëse vetëm edhe një grimcë mungon për nisab, nuk është obligim të jepet zekati. Njëjtë, zekat nuk jepet as për argjendin e rremë i cili si metal i pastruar arrinë masën e kërkuar, derisa është obligim të jepet për ar të papërpunuar ose argjend, për enë nga ari e argjendi - nga të cilat edhe ashtu është e papëlqyer të hajë, dhe në zbukurime nga ari për meshkujt. Por, nëse ari i gruas është për stoli, për të nuk jepet zekat.

Për atë që ka dhënë borxh, nëse ka mundësi e jep zekatin për borxhin që do t'i kthehet, e nëse nuk ka, pasi t'i kthehet borxhi e jep zekatin edhe për vitet e kaluara.

⁸ 1 *Miskal*, masa prej 24 kiratësh = 4.68 gramë.

Sipas matjeve të sotme nisabi i arit është 80.18 gr., disa thonë 85 gr, e vlera që duhet dhënë zekat është 2.5%.

Nisabi i argjendit është 641.46 gr., e disa thonë 700 gr, e vlera që duhet dhënë zekat është 2.5%.

ZEKATI PËR MALLRA TREGTIE

Edhe për këtë lloj të pasurisë zekati është farz, njëjtë si për ari dhe argjend. Viti llogaritet nga momenti i posedimit të parasë me të cilën do të blejë mall, nëse arrijnë vlerën e nisabit. Nëse jo, ose mallin e huazon, viti llogaritet nga momenti i blerjes së mallit.

Në këto raste duhet dhënë zekat, e vlera caktohet sipas valutës lokale. Nëse malli blihet me para që arrijnë vlerën e nisabit, më e drejtë është që vlerësimi të caktohet 2.5 %, e jo me valutë lokale. Për atë që bën tregti me para të veta, vitit nuk llogaritet prej nijetit, por prej momentit kur blen një pjesë të mallit. Obligimi i zekatit hiqet kurdo që vendosë ta ndalojë tregtinë, para se të kalojë një vit, ani pse më e mirë është që edhe për atë kohë ta japë zekatin. Prej fitimit në mall në fund të vitit obligim është të jepet zekat nëse investimin bazë e posedon për një vit, dhe për fitim të ri nuk pret të kalojë viti, siç pret te rritja e kafshës.

Për paratë e bankierit (paratë në shkëmbim) viti nuk ndërpritet me ndërrim të parasë, siç ndodh me mallëra tjerë, deri sa zekati në fitimin nga huaja i bie huadhënësit, qoftë edhe para dhënies së huasë. Kjo është më e pranueshmja.

ZEKATI NË RIKAZ

*Rikaz*⁹ është pasuri e gjetur, e mbuluar nën dhé para islamit, për të cilën nuk dihet pronari. Ai që e gjen, e bëhet fjalë për ar ose argjend, e ka obligim ta japë 1/5, e nuk merret parasysh kalimi i vitit. Më e drejtë është të mos merret parasysh as nisabi, sepse obligimi që ta japë 1/5 e vërteton ngjashmërinë e kësaj me plaçkën e luftës, ani pse edhe ky mall harxhohet, sikur zekati. Prandaj kjo është më e drejta për këto dy metale të çmueshme.

Për minerale që nuk posedojnë ari dhe argjend nuk jepet zekat. Kur ari dhe argjendi pastrohet nga këto minerale, sipas mendimit më të drejtë jepet 2.5%. Edhe nisabi trajtohet sipas këtij mendimi. Për çështjen e kalimit të një viti ka mendime të ndryshme, pos nëse është vendosur të jetë 1/5. Edhe për nisabin ka dy mendime. Më e drejta do të ishte, e Allahu Teala e di më së miri, që në çështjen e vlerës së zekatit të përcjellet principi i mallit tregtar, sepse ai është një lloj i fitimit.

Kalimi i vitit llogaritet sikur të zekati për produktet bujqësore, e mos-marrja parasysh e kalimit të vitit është më e pranueshme. Për t'u siguruar, më e mira është të ndahet 1/5, pa marrë parasysh sasinë, për të larguar dyshimet.

⁹ Zekati për thesaret e nëntokës dhe për minerale.

SADEKATUL-FITR

Sadekatul-fitr është obligim për secilin mysliman, përshtatshëm urdhrin të Resulallahut, s.a.v.s., me atë që nga ushqimi që i tepron pasi të ushqejë veten dhe familjarët në ditën e Bajramit të Ramazanit, të ndajë një *sa'*¹⁰, përcaktuar me *sa'* të Resulallahut, s.a.v.s..¹¹ Kjo masë është dy *menna* plus 2/3 e kësaj, që ky e ndanë nga ushqimi i njëjtë ose nga pjesa e saj më e mirë. Kështu, nëse ushqehet me grurë, nuk i lejohet të japë elb, e nëse ushqehet me drithëra të ndryshme, atëherë ndanë nga më e mira, ani pse mund t'i vlejë nga cila do që ndanë. Atë që e ndanë duhet shpërndarë, sikur te zekati në pronë, ku është e domosdoshme të përfishen të gjitha kategoritë e pranuesve. Nuk lejohet ndarja e drithit të bluar dhe miellit të hollë.

Mashkulli mysliman është i obliguar (atë ditë) të japë *sadekatul-fitr* edhe për gruan e tij, dhe për ata që i ka nën mbikqyrje, fëmijët dhe gjithë farefisin që ky e furnizon, pra, për të gjithë ata që ky e ka obligim t'i ushqejë. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Jepeni *sadaku-fitr* për ata që mbesin pas jush!”¹²

¹⁰ *Sa'* – masë për grurë; në Hixhaz 4 *mudd*, Irak 8 *ratle*; 1040 dërhemë.

¹¹ Muttefekun alejhi.

¹² Darekutni dhe Bejheki, sipas të cilit zinxhiri i transmetuesve nuk i është i fortë.

Është obligim të paguhet sadakul-fitr edhe në skllavin e përbashkët, për të dy pronarët e tij, e nuk jepet për skllavin e pabesimtarit. Lejohet edhe që gruaja, nëse dëshiron të japë për vete sadakul-fitr, deri sa burri i saj mund ta paguajë për të, pa lejen e saj. Nëse është në mundësi të japë vetëm për disa, atë sasi do ta japë për disa prej tyre, e në atë rast më e drejta është të japë për ata anëtarë të familjes për të cilët e ka më shumë obligim të sigurojë furnizimin. Resulallahu, s.a.v.s., në furnizim i jepte përparësi fëmijës ndaj gruas, dhe gruas ndaj skllavit.¹³

Të gjitha këto janë rregulla të fikhut, të cilat duhet njohur. Ka aty edhe raste të rralla të cilat nuk i trajtuam këtu, e për të cilat personi duhet të kërkojë zgjedhje vetëm pasi të lajmërohen, por vetëm pasi të mbizotërojnë këto që u përmendën më lartë.

¹³ Muslimi dhe Ebu Davud.

Kapitulli i dytë

KUSHTET (SHARTET) E DHËNIES SË ZEKATIT SI DHE ADABI ZAHIR DHE BATIN I TYRE

Kushtet zahir të dhënies së zekatis

Dije, kush jep zekat, e ka obligim të respektojë këto pesë kushte:

Kushti i parë është nijeti. Kusht është ta bëjë nijet nga zemra që po e jep zekatin farz (të obliguar). Nuk ka nevojë ta cekë se për cilën pasuri po e jep zekatin. Nëse ka diçka prej pasurisë e cila për momentin nuk është me të, do ta theksojë se ky zekat është për filan pasurinë dhe atë vetëm nëse atë pasuri e ka të sigurt. Nëse nuk është i sigurt, e pranueshme (*xhaiz*) është nëse e bën nijet që është sadaka, e jo zekat. Kur jepet zekat prej pasurisë së të çmendurit dhe fëmijës, mjafton nijeti i përfaqësuesit (vekil) të tyre. Për atë që refuzon të japë zekat, nijeti i sulltanit mjafton për t'ia marrë me forcë zekatin. E, nëse ai prapë refuzon, nuk mund të shpëtojë nga përgjegjësia tek Allahu.

Nëse me nijet të veçantë e autorizon dikë tjetër të japë zekatin, kjo do t'i mjaftojë, sepse autorizimi me nijet është njëjtë si vet nijeti.

Kushti i dytë është të ngutet me dhënien e zekatit sapo të mbushet viti. Sadakanë e fitrit nuk duhet ta shtyejë pas namazit të Bajramit, e obligimi i dhënies fillon me lindjen e Diellit në ditën e fundit të Ramazanit, e mund të jepet edhe më herët, gjatë muajit të Ramazanit. Ai që pa arsye e shtyen dhënien e zekatit bëhet gjynahqar.

Nëse ka kujt t'ia ndajë zekatin dhe e ka rastin, me shtyerje të dhënies së zekatit, edhe nëse e humb tërë pasurinë, borxhi nuk i hiqet.¹⁴

Nëse dhënien e zekatit e shtyen sepse nuk ka kujt t'ia japë, e pastaj prona i humbë, në këtë rast i hiqet obligimi. Lejohet dhënia para kohe, me kusht që është arritë nisabi dhe ka kaluar një vit i plotë. Lejohet të jepet para kohe edhe për dy vite.

Nëse e jep para kohe, e fukaraja vdes para se të kalojë një vit, ose del nga islami, ose bëhet i pasur, ose shkatërrohet pasuria e pronarit, kthimi i zekatit që është dhënë para kohe nuk është i mundur, pos nëse e ka bërë kusht me rastin e dhënies. Prandaj ai që e jep zekatin para kohe, duhet të ketë kujdes në atë që vjen dhe a do t'i jetë dhënia e drejtë.¹⁵

¹⁴ Sipas medh'hebit Hanefi, nëse e humb tërë pasurinë, borxhi i zekatit i hiqet.

¹⁵ Sipas medh'hebit Hanefi, zekati që jepet përpara nuk mund të kthehet, por, nëse zekati është marrë nga personi i caktuar nga vali u, atëherë kur e humb pasurinë, mund ta rimarrë pjesën që e ka dhënë zekat.

Kushti i tretë është të mos japë kundërvlerë, por të japë saktë atë që i caktohet. Për shembull, nuk lejohet të jepet zekati i dukatit në argjend, ose zekati i argjendit në ari, edhe nëse jep më shumë se vlera. Ai që nuk e kupton qëndrimin e Imam Shafisë për këtë çështje, e kupton këtë sipërfaqësisht dhe mendon se qëllimi është të zhduket varfëria, sa larg është ai nga ajo që dëshirohet! Largimi i varfërisë synohet, por kjo nuk është e tëra. Zaten, gjërat që sheriat i ka bërë të detyrueshme (*vaxhib*) ndahen në tri pjesë:

1) Pjesët që i takojnë vetëm ibadetit dhe zbatohen sepse janë urdhëruar (*taabbudi*).¹⁶ Në këto nuk kërkohet asnjë qëllim dhe mendja nuk mendon për to. E tillë është për shembull hudhja e gurëve nga haxhilerët në Mina; mendja nuk sheh ndonjë dobi në hudhjen e gurëve aty. Këtu, qëllim i shariatit është sprovë. Mendja, duke shfaqur gjendjen e nënshtrimit me veprimin që nuk e kupton, përfiton përvojë. Zaten, qëllimin e veprimit që e kupton, e bën me dëshirë dhe aty nuk kuptohet sinqeriteti i nënshtrimit. Sinqeriteti shfaqet vetëm në ibadetin që zbatohet për ta vërtetuar bindjen ndaj Allahut. Shumica e veprimeve të haxhillëkut janë pikërisht të këtilla, zbatohen sepse janë urdhëruar.

¹⁶ Në çështjet të shariatit, një pjesë i thuhet '*taabbudi*', që nuk janë të lidhura me gjykim të mendjes; mendja nuk mendon për to dhe i zbaton sepse janë urdhëruar. Një pjesë i thuhet '*makul-ul mana*', domethënë se kanë një hikmet dhe janë logjike.

Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., duke e veshur ihramin, ka thënë:

“Të përgjigjem me haxh, besnikërisht, në robëri!”¹⁷, duke shfaqë nënshtrimin ndaj urdhërit dhe angazhim në ibadet sipas rregullave, pa pasë nevojë që mendja të përfshihet në thelbin e çështjes.

2) Urdhërat që janë të logjikshëm (*makul*). Për shembull kthimi i borxhit njerëzve dhe kthimi i mallit të grabitur. Nuk ka dyshim se në këso raste nuk janë të rëndësishëm vet akti dhe nijeti. Kur një e drejtë i kthehet atij që i takon, ose me pajtimin e tij ndryshon, obligimi si i tillë, nga ana e shariatit, përmbushet.

Këto dy pjesë nuk kanë pikë të përbashkët mes vete, dhe njerëzit i kuptojnë, si pjesën e parë, edhe të dytën.

3) Këto janë urdhërat e shariatit që përbëhen nga dy pjesët e mëparshme, pra e kanë edhe anën e logjikshme (*makul*) edhe pjesën që zbatohet sepse është urdhër (*taabbudi*). Kështu, personi i cili është i ngarkuar me zbatimin e urdhërave të shariatit (*mukelef*) me këtë sprovohet. Në urdhëra të tilla duhet të mblidhen të dy kuptimet, e të merret ajo që është më qartë dhe më e lehtë për tu kuptuar, e më e rëndësishmja është të mos brakisët nënshtrimi dhe zbatimi i urdhërave.

¹⁷ Bezzar dhe Darekutni në *el-ilel*, nga Enesi.

Zekati bën pjesë pikërisht në këtë të tretën, e këtë e ka vërejtur vetëm Imam Shafi, r.a.. E drejta e të varfërit në zekat është për plotësimin e nevojës së tij; kjo është logjike dhe gjithkush mund ta kuptojë. Mirëpo zekati e ka edhe pjesën që i takon ibadetit dhe zbatohet sepse është urdhëruar, e që është qëllimi kryesor i sheriatit, e këtë gjithkush nuk mund ta kuptojë. Për këtë arsye, ku është urdhëruar namazi, menjëherë më pas është urdhëruar zekati. Prandaj edhe është thënë: *zekati është vëllai i namazit*. Kjo është arsyeja pse zekati i është bashkëngjitur namazit dhe haxhit si shtyllë e fesë.

Nuk ka dyshim se i obliguari me shariat (*mukellef*) duhet të investojë mund në mbikqyrjen e pasurisë së vet dhe në ndarjen e një sasive të caktuar nga secili lloj, dhe më pas në shpërndarjen e asaj sasive në tetë kategoritë e atyre që ju jepet zekat, e që do t'i shpjegojmë më vonë. Çasja e pamenduar ndaj kësaj nuk ka rëndësi për varfërinë, por është jashtëzakonisht e rëndësishme në çështjen e nënshtrimit dhe në zbatimin e urdhrit të sheriatit, e ky edhe është qëllimi. Përcaktimin e llojeve të ndryshme të tij e kemi shpjeguar në librat për dallimet brenda fikhut. Më e kuptueshmja është ajo se sheriatit për pesë deve e cakton një dele si zekat, ku nga deveja ka kaluar në dele, jo në para apo ndonjë kundërvlerë tjetër.

Nëse thuhet se kështu është caktuar për shkak të mungesës së parave të arabët, ky argument nuk vlen sepse - nëse nuk gjendet deveja në moshën e përcaktuar për zekat, njëjtë është caktuar që të jepen dy dele ose njëzet derhemë, dhe kjo dëshmon që nuk është në pyetje mungesa e parave.

Kjo, dhe dëshmi të ngjashme tregojnë se edhe zekati, njëjtë si haxhi, nuk është vetëm i arsyeshëm (*makul*) por përmbanë edhe pjesën që nuk është e lidhur me gjykimin e mendjes (*taabbudi*). Por, njerëzit e palogjikshëm, meqenëse nuk i kuptojnë dispozitat e tilla, bëjnë gabime.

Kushti i kartërt është që zekati të mos dalë jashtë qytetit, sepse sytë e fukarave të qytetit të vet janë të drejtuar në pronën e tij. Bartja e zekatit në vend tjetër do të ishte dëshpëruese për ta. Sipas njërit prej mendimeve, edhe kjo është e mundur, ani pse më e drejtë është t'i iket çfarëdo lloj dyshimi. Prandaj, zekati duhet shpërndarë në vendin ku edhe është mbledhur, e më pas mund t'ju jepet edhe të huajve në atë qytet.

Kushti i pestë është që zekatin ta ndajë në të gjitha kategoritë e cekura me Kur'an, në qytetin e vet, e që është *vaxhib* (obligim) sipas fjalëve të Allahut Teala:

Lëmosha (zekati) u takon vetëm të varfërve, të gJORËVE, atyre që e mbledhin atë (rrogë e nëpunësit që punon në atë lëmë), atyre që duhet përfituar zemrat (për islam); e duhet dhënë edhe për lirim nga skllavëria, të ngarkuarve në borxhe, (luftëtarëve) në rrugën e Allahut dhe për udhëtarët e mbetur rrugëve.” 9-Tebue: 60

Sot, në të shumtën e vendeve nuk ekzistojnë më dy kategori. Këta janë ata, zemrat e të cilëve duhet përfituar për islam dhe ata që e mbledhin zekatin, deri sa katër kategoritë tjera gjenden gjithkrah: të varfërit, të gJORËT, të ngarkuarit në borxhe, dhe udhëtarët që kanë mbetur në rrugë, deri sa dy kategori gjenden vetëm në disa vende – luftëtarët në rrugën e Allahut dhe skllavët që është e mundur të lirohen. Nëse në një vend gjenden njerëz që meritojnë zekatin në pesë kategori, zekatin e ndanë në pesë pjesë të barabarta. Më pas, nëse dëshiron e ndan çdo pjesë barabartë, ose ndryshe, në tre ose më shumë pjesë më të vogla, dhe e jep. Për çdo kategori e ndanë barabar, por nuk është kusht që secilit individ t’i jepet shuma e njëjtë. Më pak se tri ndarje brenda kategorisë, nuk është e përshtatshme.¹⁸

¹⁸ Sipas Imam Ebu Hanife dhe Imam Malikm xhaiz është t’i jepet zekati një kategorie, bile sipas medh’hebit Hanefi xhaiz është t’i jepet një personi.

Nëse një person është i obliguar të jep vetëm një fitr dhe në qytetin e tij gjenden pesë kategori njerëzish që ju takon sadakaja, këtë fitr do të duhej t'ua ndajë pesëmbëdhjetë njerëzve, duke përfshirë nga çdo kategori tre njerëz. Nëse dikujt i jep më pak, *vaxhib* është që këtë ta plotësojë. Nëse ndarja e barabartë do t'i paraqiste vështirësi, sepse bëhet fjalë për shumë më të vogël, le të bëhet bashkë me të tjerët që e kanë obligim të japin zekat.

SHPJEGIM I FINESAVE TË EDEBIT TË BRENDSHËM TË ZEKATIT

Dije se ai që e dëshiron udhëtimin e ahiretit, në dhënien e zekatit ka tetë detyra:

Detyra e parë, të kuptuarit e obligueshmërisë së zekatit, domethënies dhe qëllimit të sprovës në të dhe pse është një prej shtyllave të islamit ani pse është ibadet material, jo trupor. Ky kuptim i përfshinë tri kuptime:

Kuptimi i parë ka të bëjë me shqiptimin e *kelime-i-shehadetit*, e që kërkon domosdoshmërinë e tevhidit dhe dëshminë se i Adhuruari është Një. Kusht i përmbushjes së kësaj dëshmie është se në zemër të besimtarit nuk mbetet askush e asgjë që dashurohet pos Allahut, sepse dashuria (*mehabba*) nuk pranon ortak. Tevhidi vetëm me gjuhë nuk ka shumë dobi. Grada e dashurisë (muhabbetit) matet me ndarjen nga dashuritë tjera. E pasuria është një dashuri i njerëzve nga pikpamja që ajo ju siguron mjete për jetesë. Bile, për shkak të pasurisë lidhen me këtë botë, e urrejnë vdekjen, ndërsa me vdekje realizohet takimi me të Dashurin e vërtetë. Pra, për ta dëshmuar sa janë besnikë në këtë dashuri, ata janë sprovuar me dhënien e pasurisë që më shumë e dashurojnë. Prandaj Allahu Teala thotë:

“Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të Xhenetit.”9-Teube: 111

Këtu mendohet në xhihad në të cilin dhurohet jeta për rizanë e Allahut, e dhurimi i pasurisë është më i lehtë se kjo. Nëse ky kuptim i dhënies së pasurisë është i qartë, atëherë njerëzit ndahen në tri grupe:

Grupin e parë e përbëjnë ata që e vërtetuan tevhidin, e përmbushën betimin dhe hoqën dorë nga e gjithë pasuria duke mos mbajtur as një dërhëm. Të tillët refuzuan të jenë nën obligim të zekatit aq sa, kur pyeteshin:

- *Sa jepet zekat për dyqind dërhëm?*, thoshin:

- *Sipas shariatit pesë dërhëmë, e sipas neve – të gjitha*”.

Prandaj Ebu Bekr, r.a., e dha gjithë pasurinë, e Omeri, r.a., gjysmën. Kur Resulallahu, s.a.v.s., i pyeti:

- ***Çfarë ju latë familjeve?***; Omeri u përgjigj:

- *Gjysmën*; ndërsa Ebu Bekri, r.a., tha:

- *Allahun dhe të Dërguarin e Tij*.

Në këtë, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Dallimi mes juve dyve është sa dallimi mes fjalëve tuaja***.¹⁹

Ai që është siddik (si Ebu Bekri) e tregon besnikërinë e vet duke mos i lënë asgjë vetes, përveç Allahut dhe Pejgamberit, s.a.v.s..

¹⁹ Ebu Davud, Tirmidhi dhe Hakim nga Ibn Omeri.

Grupi i dytë është një gradë më poshtë se i pari. Këta janë ata që posedojnë pasuri, e nuk e japin të gjithën. Ky grup nuk kufizohet në shumën e caktuar të zekatit, por jep edhe më shumë, dhe e japin një pjesë e pasurisë në rrugë të hairit. Një grup i taibinëve (gjenerata pas as'habëve) mbanin qëndrimin se myslimanët e pasur përveç zekatit kanë edhe detyrim tjetër. Të këtillë ishin Nehai, Sha'bi, Atta dhe Muxhahid. Kur e pyetën Sha'bin se a ka njeriu detyrim tjetër për pasurinë përveç zekatit, ai tha:

*- Natyrisht! A nuk i keni dëgjuar fjalët e Allahut Teala:
"pasurinë që e do ua jep të afërmve..." 2-Bekare: 177.*

Edhe ajetet:

"...dhe nga ajo, me çka Ne i furnizuar, ata japin."

8-Enfal: 3,

dhe:

"Dhe jepni nga ajo që Ne u kemi dhënë juve..."

63-Munafikun: 10,

ishin dëshmi e tyre. Ata konsideronin se këto ajete nuk shfuqizojnë ajetin për zekat, dhe mendonin që secili pasanik kur takon nevojtarin, duhet ta ndihmojë, edhe jashtë zekatit. Ndihma nevojtarit në kushte të rënda, sipas mendimit të fakihëve është *farzi-kifaje*, sepse kurrsesi nuk lejohet që myslimani të shkatërrohet. E ai që e ka dhënë zakatin, siç mund t'ia huazojë atë sasi besimtarit, mund ta japë, atë sasi ose edhe më shumë, e të mos jetë borxh.

Njerëzit ndahen në këtë çështje, deri sa ndihma me borxh nevojtarin është grada më e ulët, që janë edhe grupi i tretë.

Pra, *grupi i tretë* përbëhet nga ata që kufizohen vetëm në *vaxhib* (obligim), pa i shtuar apo hequr diçka. Pikërisht këtu janë shumica, për shkak të koprracisë së tyre, pëlqimit të pasurisë dhe dashurisë së dobët për ahiretin. Allahu Teala thotë:

“Sikur ta kërkonte prej jush tërë pasurinë me këmbëngulje, ju do të bëheshit koprracë.”

47-Muhammed: 37

Me siguri është dallim i madh në mes të atyre të cillëve ju është blerë pasuria dhe jeta në këmbim të Xhenetit, dhe atyre të cilët për shkak të koprracisë së tyre, nuk jepin.

Ky është kuptimi i parë ose domethënia pse Allahu Teala ju ka urdhëruar robëve të Tij të japin nga pasuria e tyre.

Kuptimi i dytë është pastrimi nga koprracia, e që është ves i keq. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Tri gjëra çojnë në shkatërrim, koprracia e tepërt, vesi që pasohet dhe vetëpëlqimi.”²⁰

²⁰ Është përmendur më herët.

Allahu Teala thotë:

“Kushdo që ruhet nga koprracia e vetvetes, me siguri që do të jetë fitues.” 59 - Hashr: 9

Në vëllimin e tretë [RUB’U’L-MUHLIKAT] do të shpjegojmë rrezikun dhe mënyrën e shpëtimit nga kjo. Shpëtimi nga koprracia është i mundur duke e bërë shprehi dhënien e pasurisë në vend të duhur. Ndërprerja e dashurisë për diçka është e mundur me largimin nga ajo. Në këtë kuptim, zekati pra është pastrim. Ajo e pastron personin nga koprracia, që është e rrezikshme, e pastrimi nga kjo matet me sasinë që e dhuron dhe gëzimin e tij që po jep në rrugë të Allahut.

Kuptimi i tretë është falënderimi për nimetin (mirësinë), sepse Allahu Teala te robi i Vet ka nimete, edhe në trupin e tij edhe në pasurinë e tij, ibadetet trupore janë falënderim për nimetet e trupit, deri sa me pasuri bëhet falënderimi për nimetet në pasuri. Askush nuk mund të jetë më i poshtër se ai që është i pasur dhe shikon me sytë të vet dhe dëgjon me veshët e vet që një vëlla mysliman ka rënë në varfëri dhe ky prej pasurisë që ia ka dhuruar Allahu Teala nuk ia jep 1/10 ose 1/40 atij nevojtar, e kështu nuk i lejon vetes të jetë falënderues ndaj Allahut për këtë nimet.

Detyra e dytë ka të bëjë me kohën e dhënies së zekatit. Adab i atyre që i frikësohen Allahut është ngutja në këtë, që diçka të mos e pengojë, pra jepen sa më parë, duke shprehur vullnetin për të zbatuar urdhrin dhe duke menduar rëndësinë e gëzimit të fukarasë. Shtyrja e afatit sjell dëm dhe është gjynah. Sa herë që në brendësi të ndjejë nxitje për vepër të mirë, duhet të gëzohet dhe këtë duhet shfrytëzuar, dhe ta dijë se kjo është frymëzim i melekut. Zemra e besimtarit është mes dy gishtave të fuqisë së Rahmanit dhe Ai e rrotullon ashtu si Ai do. Shejtani vazhdimisht frikëson me skamje dhe nxitë në të keqe e shkatërrim. E vesvese e shejtanit lajmërohet menjëherë pas frymëzimit të melekut. Prandaj duhet të përfitojë nga rasti i parë dhe menjëherë të jep zekatin. Për ta shtuar sevapin dhe shpërblimin duhet të zgjedh kohën më të mirë dhe muajt me vlerë si Muharrem, muajin e parë të vitit, ose gjatë muajit të Ramazanit. Resulallahu, s.a.v.s., ishte njeriu më i xhymert, e në muajin Ramazan *ishte sikur era, çka i vinte në dorë menjëherë e jepte*.²¹

Gjithashtu, Ramazani ka edhe vlerën e *Lejletul-kadr*, e në të është shpallur edhe Kur'ani. Bile Muxhahidi do të thoshte: *“Mos thoni ‘Ramazan’, sepse një prej emrave të Allahut Teala, është Ramazan, por thuani ‘muaji i Ramazanit’!”*

²¹ Muttefekun alejhi.

Edhe muaji Dhul-hixhe është prej muajve me vlerë të madhe. Është muaj i shenjtë, sepse në këtë muaj është farzi i haxhit, ditët e njohura (*ejjam-i ma'lumat*) dhe ditët e teshrikut (*ejjam-i ma'dudat*). Në muajin e Ramazanit më të vlefshmet janë dhjetë ditët e fundit, e në muajin Dhul-hixhe dhjetë ditët e para.

Detyra e tretë është fshehtësia, për t'u mbrojtur prej dyfytërisë (*rija*) dhe lavdrimit, zekati dhe sadakaja jepet fshehtas. Lidhur me këtë, Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Sadakaja më e vlefshme është ajo të cilën ai që nuk është pasanik ia jep fukarasë, fshehtazi.”²²

E me një hadith tjetër thotë:

“Tri gjëra janë nga thesari i mirësisë, e njëra është fshehja e sadakasë”²³

E Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu ka thënë:

“Robi e bën një veprim fshehtazi, dhe Allahu ia shënon fshehtazi, e nëse ky e shfaqë, atëherë nga e fshehta i bartet dhe i shkruhet haptas, e nëse për të edhe fillon të flasë, atëherë i largohet edhe nga e fshehta edhe nga haptas, dhe i shkruhet si dyfytëri (rija),²⁴ dhe:

²² Ahmedi, Ibn Hibban dhe Hakimi nga Ebu Dherr, si edhe Ebu Davud nga Ebu Hurejre.

²³ Ebu Nuajm në librin ‘*Kitabu’l-ixhaz’* nga Ibn Abbasi.

²⁴ Hatibi në ‘*Tarih’* nga Enesi.

“Shtatë persona Allahu do t’i vendosë nën hijen e rahmetit të Tij, atë ditë kur nuk do të ketë hije tjetër pos hijes së Tij. Njëri prej tyre është edhe ai që ka dhënë sadaka, e dora e tij e majtë nuk e ka ditur se çfarë ka dhënë dora e tij e djathtë”²⁵, dhe ka thënë:

“Sadakaja e dhënë fshehurazi e shuan zemërimin e Allahut.”²⁶

E Allahu Teala thotë:

“...por nëse ato ua jepni të varfërve fshehurazi, ajo është edhe më e mirë për ju...” 2-Bekare: 271

Përfitimi i dhënies së sadakasë fshehtas është mbrojtja nga dyfytyrësia. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Allahu nuk i pranon veprat e dyfytyrëshit dhe atij që lavdërohet.”²⁷

Ai që lavdërohet për sadakanë e vet kërkon që të përhapet zëri i mirë për të e ai që jep para të tjerëve synon dyfytyrësinë. Nga këto ruhemi me fshehje dhe heshtje. Bile një grup aq shumë preferonte të fshehtën sa mendohej që pranuesi i sadakasë të mos e dijë kush ia jep.

²⁵ Muttefekun alejhi nga Ebu Hurejre r.a.

²⁶ Taberani nga Ebu Umame.

²⁷ Hadithi nuk ka burim të njohur.

Disa kanë preferuar të verbrit, disa e linin aty ku ulet fukaraja, disa ia qepnin në rroba fukasasë kur ai flinte, e disa e jepnin me ndërmjetësues. Qëllimi në të gjitha këto ishte largimi nga dyfytyrësia e lavdërimi dhe të jenë të mbrojtur nga zemërimi i Allahut Teala.

Për të qenë i panjohur, më mirë është që sadakanë t'ia dorëzojë një vekili. Në njohjen e dhuruesit nga fukaraja fshihet edhe dyfytyrësia edhe dëshira për mirënjohje, derisa përmes ndërmjetësuesit mund të ketë vetëm dyfytyrësi. Në atë çast kur qëllimi i ekspozohet si dëshirë për mirënjohje, vepra i shkatërrohet, sepse zekati në fakt do të duhej të largojë koprracinë dhe të dobësojë dashurinë për pasuri. Dashuria për famë është më e keqe se sa dashuria për pasuri, e të dyja në ahiret njeriun e dërgojnë në shkatërrim.

Koprracia në varr merr formën e një akrepi të helmuar ndërsa dyfytyrësia formën e gjarprit helmues, Obligim i njeriut është t'i frikësojë këto cilësi me vdekje, që të mbrohet nga e keqja e tyre, ose ta zbus atë. Nëse dëshiron të largohet nga cilësia e koprracisë, e në anën tjetër, kur jep pasuri anon kah dyfytyrësia dhe lavdërimi, kjo është sikur të ushqejë akrepin dhe gjarprin. Më pak e dëmshme do të ishte të mbetesh në gjendjen që ka qenë.

Këto cilësi forcohen me veprimet që i shkaktojnë, e dobësimi i tyre është i mundur vetëm me luftë shpirtërore (*muxhahede*), me refuzimin e tyre dhe me veprime të kundërta me veprimet që i shkaktojnë. Çfarë dobie ka të luftohet dëshira për koppraci e t'i përshtatet dëshirës për dyfytyrësi; të dobësohet ajo që është e dobët e forcohet ajo që është e fortë? Për fshehtësitë e këtyre kuptimeve do të flasim më gjerësisht në volumnin 'Rub'u'l- Muhlikat'.

Detyra e katërt: sadakanë ta japë haptas kur e di se kjo do të nxisë edhe të tjerët, duke u ruajtur nga rijallëku, siç do ta shpjegojmë në *Librin për dyfytyrësinë*. Allahu Teala thotë:

“Nëse sadakanë e jepni haptazi, kjo është mirë...”

2-Bekare: 271,

kur rrethanat e lejojnë, që të tjerët të nxiten ose kur fukaraja lypë haptas, e atëherë nuk duhet ngurruar, por duhet të japë duke e ruajtur, aq sa mundet, nga dyfytyrësia.

Në dhënien haptas fshihet edhe cilësia e tretë e papëlqyer – cenimi i nderit të fukarasë, sepse ai ndjen mërzë kur kuptohet se është fukara. Por, ai që lyp haptas e ka heq vet këtë pangesë dhe e ka zbuluar gjendjen e vet. Është e ndaluar të hulumtohen këto të meta të fshehta, mirëpo për ata që haptas bëjnë vepra të këqija, pasi që vet janë sebeb, nuk ka pengesë të tregohen.

Në këtë kuptim, Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kush e heq perden e turpit, të flasësh kundër tij nuk vlerësohet përgojim (gibet).”²⁸, e Allahu Teala thotë:

“...nga begatitë që Ne u kemi dhënë japin fshehtazi e haptazi.” 35-Fatir:29.

Edhe dhënien haptas e bëri të lavdëruar sepse në të është dobia e nxitjes së të tjerëve. Prandaj njeriu duhet të mendojë me kujdes gjatë krahasimit të kësaj dobie me të papëlqyerën që një veprim i tillë e bartë. E gjitha kjo ndryshon varësisht rrethanave dhe personit. Në disa situata dhe për disa njerëz dhënia haptas është më e mirë. Ai që i njej përparësitë dhe mangësitë nuk do të shikojë me syrin e dëshirës, por do ta ketë të qartë se çfarë është më e drejtë, për secilin rast.

Detyra e pestë: që sadakanë e vet të mos e prishë duke u kënuar e duke ofenduar. Allahu Teala thotë:

“mos i prishni sadakatë tuaja me të kënuar e me ofendim.” 2-Bekare: 264

Mufesirët u ndanë në atë se çfarë mendohet me *të kënuar* (menn) dhe me *ofendime* (eza), e thanë se ‘*me të kënuar*’ është përmendja e vazhdueshme e sadakasë ndërsa që ‘*ofendim*’ është dhënia e saj haptas.

²⁸ Ibn Adijj në ‘*Dhuafa*’

Sufjani ka thënë: “Kush krenohet për sadakanë që e ka dhënë, ajo i shkatërrohet.” Njerëzit e pyetën:

- Si bëhet ajo e krenuar?, e Sufjani tha:

- Kur e përmendni dhe flisni për të.

Disa thanë se shihet edhe në përdorimin e fukarasë për punë të veta, e të folurit për sadakanë që fukaranë ta turpërojë për varfërinë e tij është ofendim. Gjithashtu, thuhet se të krenuarit shihet edhe në fodullëkun karshi fukarasë për shkak që i ka dhënë sadakanë, deri sa ofendim është poshtërimi i fukarasë me fjalë të këqija. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Allahu nuk e pranon sadakanë e atij që vazhdimisht e përmend atë sadaka.”²⁹

Sipas meje, të krenuarit (*menn*) e ka një burim edhe një rrënjë, që është cilësia e zemrës dhe gjendja e saj, e më pas nga kjo rrënjë dalin degë tjera. Ato degë manifestohen në gjuhë dhe gjymtyrë.

Krejt kjo fillon kur personi që i jep nimet fukarasë e sheh veten si mirëbërës, e në fakt do të duhej që fukaranë, i cili e merr atë që është nimet i Allahut, ta shohë si mirëbërësin e tij, që e pastron dhe e shpëton nga zjarri.

²⁹ Hadithi nuk është gjetur në burimet relevante.

Sikur fukaraja të mos e pranonte sadakanë e tij, ky borxh do t'i mbetej në qafë, e do të duhej më vonë ta përmbushë. Prandaj nuk duhet të shohë veten si mirëbërës, por duhet që fukaranë ta shohë si mirëbërësin e tij meqenëse dora e fukarasë është duke e marrë atë që i takon Allahut. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Sadakaja bjen në dorën e Allahut Teala para se të kalojë në dorë të fukarasë.”³⁰

Prandaj ai që jep zekatin dhe sadakanë duhet të jetë mirë i vetëdijshëm se vetëm po ia kthen Allahut Teala atë që është e Allahut, ku fukaraja atë furnizim e merr nga Allahu, pasi që ky ia ka dorëzuar Allahut. Nëse një person i thotë shërbëtorit për të cilin kujdeset: *“Merri këto para dhe jepja filanit që ia kam borxh”*, e shërbëtori mendon se meriton mirënjohje nga pranuesi, sepse po i bën një shërbim - kjo do të ishte mosrespekt dhe padituri e plotë. Sepse shërbëtori është vetëm një mjet, e pronari është ai që po i dërgon paratë.

Ai që meriton mirënjohje është pronari, i cili e furnizon shërbëtorin, e shërbëtori vetëm po e kthen borxhin e pronarit të vet, duke arritur kështu falënderimin e tij dhe duke mos e bërë askë borxhli ndaj vetes

³⁰ Darekutni në ‘*lfrad*’ nga Ibn Abbas.

Sa herë që t'i njohë tri domethëniet në kuptimin e obligueshmërisë së zekatit, për të cilat folëm, ose njërën prej tyre, nuk do ta shohë veten si mirëbërës, qoftë me shprehje të dashurisë ndaj Allahut përmes ndarjes nga pasuria, qoftë me pastrimin e shpirtit nga shëmtia e koprracisë, ose edhe si falënderim ndaj Allahut për nimetin e pasurisë së tij, duke kërkuar edhe më shumë. Sido që të jetë, mes atyre dyve nuk guxon të vendoset lidhja dhurues-pranues për sa kohë që ky veten e konsideron mirëbërës.

Sa herë që injoranca e nxitë të mendojë se ai është mirëbërës, menjëherë te ai lajmërohen cilësi të dukshme që i përmendëm kur folëm për të krenuarit; të gjithëve ju flet për këtë, e përhapë, kërkon kompenzim me falënderim dhe bërje të duasë, kërkon ndonjë shërbim të veçantë, madhështim, i jep vetes të drejtë, mendon se është në gradë të ndershme dhe që mendimet e tij pasohen nga të tjerët. Të gjitha këto janë frut i të krenuarit, deri sa kuptimi i brendshëm i saj është pikërisht ajo që e përmendëm.

Sa për ofendim (*eza*) dhe burimin e ofendimit, ajo shihet në qortim, turpërim, fjalë të ashpra, fytyrë të mërralor e forma tjera të përluljes. Janë dy burime:

- Mospëlqimi i tij për të ndarë nga pasuria dhe ashpërsia e tij, që padyshim i shqetëson njerëzit, dhe
- Vetën ta shohë më të mirë se fukaranë, i cili, për shkak të nevojës që ka, qenka në gradë më të ulët se ky.

Të dyja këto vijnë nga padituria. Le t'i shpjegojmë:

E para: mospëlqimi të jep nga pasuria është budallallëk, sepse nëse dikujt nuk i pëlqen të japë një dërhëm për të fituar njëmijë, atëherë ky po që është budallallëk i pastër.

Dihet se njeriu pasurinë e jep për tri arsye: jep me dëshirën për të fituar kënaqësinë (rizanë) e Allahut dhe sevap, e kjo është më e vlefshme. Ose jep me qëllim të pastrimit të vet nga papastërtia e koprracia, ose si falënderim dhe kërkim për më shumë. Sido që të jetë, nuk ka arsyetim për mospëlqim të dhënies nga pasuria.

E dyta - ta shohë veten më të mirë se fukaranë, gjithashtu vjen nga padituria, si e para. Sepse sikur njeriu ta dinte përparësinë e varfërisë ndaj pasurisë dhe të njëjtte rrezikun në të cilin gjenden të pasurit, nuk do ta nënçmonte fukaranë, por do të merrte bereqet nga ai dhe do të synonte gradën e tij. Sepse të mirët që janë edhe të pasur do të hynë në xhennet pesqind vjet pas të varfërve.

Prandaj Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“Pasha Rabbin e Qabes, ata janë në humbje.”

Ebu Dherr e pyeti:

- *Kush janë ata*, e Resulallahu, s.a.v.s.,tha:

- ***Ata që kanë shumë pasuri.***

Personi që me njëmijë vështirësi fiton, nga paratë që i kursen e ka obligim të japë aq sa i janë të nevojshme fukarasë. Ai në një mënyrë është si hyzmetqar që punon për riskun e fukarasë. E si atëherë mundet ky ta ofendojë fukaranë? Për më tepër, ai ka marrë gjithë përgjegjësinë e pasurisë mbi qafë, është lodhur me vetëdije dhe në fund detyrohet ta ruajë pasurinë deri sa të vdesë, që të mos ia marrin armiqtë. Sikur me ndihmën e Allahut ta kishte kryer obligimin ndaj fukarasë, me pranimin e fukarasë ky do të kishte shpëtuar nga obligimi, do të ishte zemërgjerë dhe i lumtur, fjalët e këqija si ofendimet, qortimit dhe fytyra e mërrolur do të ishin ndërruar me lavdërimin e fukarasë dhe me mirënjohje ndaj tij. Pra, këto janë burimet të krenuarit dhe ofendimit.

Nëse ti thua se ai që ndihmon të varfërit në mënyrën si e përshkruam është shumë e vështirë të mos e shohë veten si mirëbërës, dhe a ka për këtë ndonjë shenjë që mund ta kontrollosh zemrën dhe të sigurohesh se nuk e sheh veten si mirëbërës; dije se ka një shenjë të hollë por shumë të qartë për të mos rënë në këtë gjendje: nëse pas dhënies së sadakasë, fukaraja i bën padrejtësi, ose i bëhet armik, ose bashkohet me armikun e tij, e ky zemërohet më shumë se sa që do të zemërohej po të mos ia kishte dhënë sadakanë, atëherë sadakaja e tij nuk është pastruar nga ndytësitë e dëshirimit të mirënjohjes, për shkak që ia ka dhënë sadakanë fukarasë e ka pritë diçka tjetër prej tij.

Nëse thua se kjo është shumë e turbullt, dhe çka është ilaçi për këtë; dije se ka dy ilaçë për të shpëtuar prej kësaj sëmundje; njëra është ilaç i brendshëm (*batin*), dhe e dyta është ilaç i jashtëm (*zahir*). Ilaç i brendshëm është njohja (hakikatet) e asaj që e përmendëm për kuptimin e obligimit dhe që fukaraja, duke e pranuar sadakanë i është mirëbërës në pastrimin e tij. Ilaçi i jashtëm ka të bëjë me lëvizjet a atij që pranon mirënjohje. Sepse lëvizjet e trupit kalojnë në gjendjen e ahlakut. Fshehtësitë e kësaj do t'i shpjegojmë në fund të këtij libri.

Prandaj disa kur ia jepnin sadakanë furarasë, e lusnin fukaranë me modesti t'ua pranojë, sa pothuajse veten e vendosnin në vend të fukarasë, e nëse fukaraja i refuzonte, brengoseshin. Disa e zgjasnin dorën e mbyllur, në mënyrë që kur e hapë, fukaraja ta merr sadakanë nga dora e tij, e kështu dora e fukarasë të jetë përmbi.

Ajshe dhe Ummu Seleme, r.anha, kur i dërgonin diçka fukarasë, pyesnin atë që e dërgonte se çfarë lexonte fukaraja në dua për to, e edhe ato e bënë të njëjtën për fukaranë, duke thënë: *“Duaja për dua, që sadakaja të na jetë e pastër.”* Nuk prisnin dua nga fukaraja, sepse kjo do të ishte kompenzim, prandaj në dua përgjigjeshin me dua. Kështu vepronin edhe Omer ibnul-Hattab dhe djali i tij Abdullahu, r.a., e njëjtë kështu vepruan edhe njerëzit e mençur për të përmirësuar zemrat e tyre.

Për të jashtmen, nuk ka ilaç përpos me këto veprime që sjellin përulje, modesti dhe pranimit të mirësive, deri sa për të brendshmen, ilaçi është në kuptimet që i përmendëm. Ilaçi i jashtëm mbështetet në veprim, ndërsa ilaçi i brendshëm në dituri. E zemra nuk mund të shërohet pos me përzjerje të të dyjave, diturisë dhe veprimit. Këto kushte që kërkohen në zekat dhe sadaka, janë si kërkesa për *hushu* (përulësinë) në namaz, që e vërtetojnë fjalët e Resulallahut, s.a.v.s.:

“Personi nga namazi i tij ka vetëm aq sa ka qenë i vetëdijshëm në të.”³¹, që përshtatet me hadithin:

“Allahu nuk e pranon sadakanë e atij që flet për atë sadaka.”, e ky është edhe kuptimi i fjalëve të Allahut Teala:

“mos i prishni sadakatë tuaja me të krenuar e me ofendim.” 2-Bekare: 264.

Sa për fetvanë e fakihut se sadakaja e arrinë qëllimin e vet, sido që të jetë, dhe se në momentin e dhënies së zekatit dhuruesi e kryen obligimin, pa marrë parasysh kushtin e përmendur, kjo është çështje e veçantë. Atë kuptim e kemi treguar në *Librin për namazin*.

Detyra e gjashtë: atë që e jep të mos e shohë si të shumtë, sepse do të jetë mendjemadh, e mendjemadhësia (*uxhb*), është një gjendje shumë e rrezikshme që i shkatërron veprat.

³¹ Është përmendur në *Librin për namazin*.

Allahu Teala thotë:

“Nuk ka dyshim se Allahu ju ka ndihmuar në shumë beteja, e edhe në ditën e Hunejnit, kur juve ju mahniti numri i madh, i cili nuk ju vlejti asgjë.” 9-Teube: 25

Thuhet: *“Sa më pak ta vlerësojë njeriu ibadetin e vet, aq më shumë ai ibadet rritet te Allahu Teala, e sa më e madhe të shihet mosdëgjueshmëria, aq më e vogël bëhet ajo te Allahu.”*

Gjithashtu thuhet: *“Vepra e mirë plotësohet me tri gjëra: me vlerësimin e saj si të vogël, me ngutje në bërjen e saj, dhe me heshtjen për të.”*

Ta shohë si të shumtë atë që e jep nuk do të thotë gjithsesi *‘të krenuar’* dhe *‘ofendim’*, sepse nëse jep pasuri për ndërtimin e xhamisë, për teqe ose han, është e lejuar që atë vepër të veten ta shohë si të madhe, por nuk është e lejuar që të lavdërohet e të flasë për të. Mendjemadhësi nuk është vetëm vetëpëlqimi dhe të shihet si e shumtë sadakaja që e jep, por mendjemadhësi mund të bëhet në të gjitha ibadetet.

Shërimi i kësaj është në dituri dhe veprim. Dituri është që ta dijë se 1/10 ose 1/40 që do ta japë nga pasuria që e ka është pak dhe do të jetë i kënaqur me gradën më të ulët të dhënies, siç e shpjeguam më lartë.

Në fakt, më parë do të duhej të turpërohej që po jep një shumë aq të vogël. Edhe nëse e jep të gjithë pasurinë dhe e arrin gradën më të lartë, as këtë nuk mund ta shohë si shumë.

Prandaj mjafton të mendojë se nga i erdh pasuria dhe në çka po e harxhon! Pasuria i takon Allahut Teala, e njeriut i takon të jetë falënderues që Allahu ia mundësoi që të japë. Përse pra e paraqet veprën e vet të madhe, kur ajo është e drejtë e Allahut? Nëse e ka dhënë pasurinë për të marrë shpërblim në ahiret, përse atë që e dhuron e paraqet si të madhe, kur shpërblimi që e pret për këtë është shumë më i madh?!

Veprimi praktik shihet në atë që sadakanë e jep duke u turpëruar, sepse nga koprracia po e mbanë pjesën tjetër të pasurisë, prandaj është në gjendje të turpërimit, sikur borxhliu që e kthen një pjesë të borxhit, e pjesën tjetër e mbanë për vete. Kjo për faktin se e gjithë pasuria është vetëm e Allahut Teala, prandaj edhe dhënia e gjithë pasurisë është më e dashur për Allahun. E prapë, Allahu nuk ia caktoi këtë robit të Tij sepse kjo do të ishte e vështirë për robin, për shkak të koprracisë së tij. Allahu Teala thotë:

“Sikur ta kërkonte prej jush tërë pasurinë me këmbëngulje, ju do të bëheshit koprracë.”

47-Muhammed: 37

Detyra e shtatë: nga pasuria e vet të japë pjesën më të mirë, më të dashur, më të vlefshme, më hallall, e më të pastër, sepse Allahu Teala është i bukur dhe e pranon vetëm të bukurën. Nëse jep nga pasuria e dyshimtë, mund të mos jetë vërtetë pasuria e tij, dhe nuk arrin qëllimin. Resulallahu s.a.v.s., ka thënë:

“Lum për atë që jep nga pasuria hallall.”³²

Ndërsa llogaritet se i jep përparësi dikujt tjetër e jo Allahut Teala nëse pjesën e mirë e mbanë për vete, për hyzmetqarin ose familjen e vet, e më të keqen e jep për rizanë e Allahut. Kjo është paturupësi. Sikur të vepronte kështu me mysafirin dhe t’ia shtrojë ushqimin më të dobët, e familjes së vet ushqimin më të mirë, sigurisht kjo mysafirit ia thyen zemrën, dhe hidhërohet. Këtë duhet menduar kur e jep pasurinë për rizanë e Allahut. Edhe kur qëllim e ka që të merr sevap në ahiret, prapë duhet ta japë të mirën, sepse nuk është e arsyeshme që tjetrin të preferojë më shumë se veten.

Nga pasuria e vet ai ka vetëm aq sa jep sadaka. Kjo do t’i mbetet përgjithmonë, nërsa ushqimi dhe veshja janë nevoja të përkohshme. Prandaj nuk ka kuptim të kufizohet në diçka të përkohshme e të injorohet sigurimi i përhershëm.

³² El-Bezzar dhe Ibn Adijj.

Allahu Teala thotë:

“O ju që besuat, jepni nga më e mira e asaj që e fituat dhe nga ajo që u dhamë prej tokës, e mos nxitoni ta jepni atë më të pavlefshmen nga ajo, e që ju nuk do ta pranoni për vete vetëm symbyllas.” 2-Bekare: 267,

domethënë, nëse ju, kur ju jepen gjëra të pavlefshme nuk do t'i pranoni ato pa u vrenjtur dhe skuqur, atëherë mos jepni gjëra të pavlefshme për Allahun.

Në hadith thuhet:

“Një dërhëm ia ka kaluar njëqind mijë dërhëmëve.”³³

Mendohet në personin që jep me dashuri në rrugë të Allahut një dërhëm, prej pasurisë hallall, e në anën tjetër dikush jep njëqind mijë dërhëmë, por prej pasurisë së dyshimtë, dhe pa dëshirë. Kjo gjendje e tij tregon që ai nuk e ka preferuar rizanë e Allahut. Kështu, një dërhëm bëhet më i vlefshëm se njëqind mijë dërhëmë.

Prandaj Allahu Teala edhe i qorton ata që Allahut i përshkruajnë atë të cilën për vete e kundërshtojnë:

“Ata i veshin Allahut atë që për vete nuk e dëshirojnë kurse gjuhët e tyre flasin gënjeshtër, kur thonë se ata do të kenë shpërblimin më të mirë. Nuk ka dyshim se ata i pret Zjarri, ku do të jenë të parët që do të prijnë.”

16-Nahl: 62;

³³ Nesai dhe Ibn Hibban nga Ebu Hurejre.

Detyra e tetë: duhet të zgjidhen njerëz që sadakanë dhe zekatin e përdorin në mirësi, dhe të mos kufizohet vetëm në tetë kategoritë, sepse në to ka edhe cilësi të veçanta në të cilat duhet pasur kujdes, e që janë gjashtë:

Cilësia e parë: të zgjedhen të varfër të devotshëm që nuk brengosen për dynjallëk e që veprojnë vetëm për ahiret. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Ha ushqim vetëm prej të devotshmit, e edhe ushqimin tënd le ta hajë vetëm i devotshmi”³⁴

Ndihma që i bëhet të devotshmëve shërben që të shtohet devotshmëria e tyre. Edhe ai që ndihmon, në saje të kësaj përfiton sevap. Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Me ushqimin tuaj ushqeni të devotshmit dhe sadakanë jepni besimtarëve!”³⁵,

e në version tjetër:

“Me ushqimin tënd gostite atë që e do për rizanë e Allahut!”³⁶

Njëri dijetar, u jepte përparësi dervishëve ndaj të varfërve në ushqim, e i thanë:

³⁴ Ebu Davud dhe Tirmidhi nga Ebu Seid.

³⁵ Ibnul-Mubarek në *El-birr ves-sile* nga Ebu Seid. Ibn Tahir thotë se është garib dhe se në zinxhir të transmetuesve ka një person të panjohur.

³⁶ Po aty.

- *Më mirë të përfshije të gjithë me mirëbërje, e ai tha:*

- *Jo! Ata (dërvishët) janë njerëz që brengë e kanë vetëm Allahun Teala. Po t'i godasë skamje e madhe, dikush prej tyre mund ta humbasë atë forcë shpirtërore. Më i dashur për mua është vetëm një person që vëmendjen e ka të drejtuar kah Allahu, se sa njëmijë që mendojnë vetëm për dynjallëk.*

la treguan këtë Xhunejdit, e ai e lavdëroi duke thënë:

- *Ai është evlia. Moti nuk kam dëgjuar diçka kaq të bukur.*

Tregohet se ky person ishte pemëshitës, por nuk pranonte para nga fukaratë që vinin të blenin prej tij, e dikur falimento. Nuk dëshiroi të vazhdojë me tregti, por Xhunejdi i dërgoi një shumë parash, e i tha:

- *Merri këto për mall. Mos e mbyll dyqanin. Dikujt si ti tregtia nuk i bën dëm!*

Cilësia e dytë: sadakanë t'ua japë dijetarëve të varfër, që do t'ju jetë mbështetje në diturinë e tyre. Thellimi në mësimin e fesë me nijet të sinqertë është ibadeti më i lartë. Ibnul-Mubarek vecanërisht sadakanë ua jepte dijetarëve të varfër. Një herë i thanë:

- *Sikur t'i përfshije njëjtë të gjithë fukaratë!, e ai tha:*

- *Pas gradës së pejgamberllëkut nuk njoh gradë më të vlefshme se dituria; nëse dijetari preokupohet me ndonjë nevojë, nuk do t'i kushtohet diturisë e mësimi. Sigurimi i nevojës së tij krijon kushte të mësohet dituria, e kjo është më e vlefshme.*

Cilësia e tretë: atij të cilit i jepet sadakaja të jetë i devotshëm dhe i sinqertë në tevid. Me sinqeritet në tevid këtu mendohet që ta falënderojë Allahun dhe ta shohë si nimeti vjen prej Tij, duke mos e shikuar ndërmjetësin (njeriun). Robi më falënderues ndaj Allahut është ai që e di se secili nimet vjen vetëm prej Tij. Në porosinë për të birin, Llukmani ka thënë: “Mos e vendos mes teje dhe Allahut dikë që të jep nimetin, e nimetit që të vjen prej tjetër kujt mos i jep rëndësi!”

Ai që falënderimin ia drejton dikujt tjetër, e jo Allahut Teala, ai nuk e njeh atë që ia jep nimetin dhe nuk e ka kuptuar se ndërmjetësimi realizohet me urdhrin jyjnor. Sepse robi jep nimete në saje të sebepeve që i krijon Allahu Teala. Robi është nën urdhrin e Allahut. Pasi që Allahu Teala në zemër ia ka mbjellur se selameti i besimit dhe dynjallëkut të tij është në dhënien e nimetit, ai nuk e braktisë dhënien kurrë. Kur forcohet impulsi, kjo e drejton atë në dhënie, prandaj robi nuk kundërshton.

Allahu Teala është që krijon vullnetin, që përgatit njetin, që largon dobësinë dhe dyshimet dhe që përegadit forcën për t'u realizuar ky vullnet. Kush është i bindur në këtë, shikimi nuk i drejtohet në asgjë tjetër pos në Shkaktarin e të gjitha shkaqeve. Bindja e një robi të tillë për dhuruesin është më e dobishme se cili do falënderim. Lëvizja e gjuhës, në të shumtën e rasteve, vetëm e zvogëlon dobinë, deri sa, nga ana tjetër, ndihma që bëhet duke ditur që nimeti është prej Allahut padyschim që nuk humb. Por ata që lavdërojnë kur iu jepet, e kur ju ndërpritet ndihma kritikojnë - gjendja e të tyre është dyfytyrësia. Transmetohet se Resulallahu, s.a.v.s., i dërgoi sadaka një fukaraje përmes një ndërmjetësi, të cilit i tha:

- Mbaje në mend çfarë do të thotë!

Kur e pranoi sadakanë, fukaraja tha:

- Hamd Allahut, i Cili nuk e harron atë që e përmend e as nuk e dërgon në shkatërrim atë që e falënderon; e më pas tha:

- O Allahu im, mos më harro dhe mos lejo që unë të harroj Ty!

Kur e lajmëruan Resulallahun, s.a.v.s., për këto fjalë, ai u gëzua, e tha:

- E dija se kështu do të thotë!³⁷

³⁷ Hadithi nuk gjendet në përmbledhjet kryesore të haditheve por ka batë në një hadith të dobët që ndërliidhet me Ibn Omer, e një tjetër hadith të ngjashëm e shënon edhe Bejheki.

Shih si ky person ishte i lidhur vetëm Allahut, dhe atë që ia dha sadakanë as nuk e permendi. Me një rast, Resulallahu, s.a.v.s., i tha një personi:

- ***Pendohu!***; në çka ai iu përgjigj:

- *Unë i bëj teube vetëm Allahut, nuk i bëj teube Muhammedit (a.s.); e në këtë Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- ***Ky e ka njohur të vërtetën, bash ashtu si duhet!***³⁸

Kur u shpall pafajësia e Ajshe, r.anha, për shpifje, Ebu Bekr (babai i saj), i tha:

- *Shko e puthe Resulallahun, s.a.v.s., në kokë!*, e ajo tha:

- *Pasha Allahun, jo! Askujt nuk do t'i falënderohem, pos Allahut!* Në këtë, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Lere të qetë, o Ebu Bekr!***, e në version tjetër të këtij hadithi thuhet se Ajshe i tha Ebu Bekrit:

- *Vetëm Allahut i falënderohem; as ty e as mikut tënd;* në çka Resulallahu, s.a.v.s., nuk kundërshtoi, edhe pse shpallja i arriti asaj përmes gjuhës së Resulallahut, s.a.v.s..

Të shihen gjërat se po vijnë prej dikujt tjetër e jo prej Allahut Teala, është cilësi e jobesimtarëve. Allahu Teala thotë:

“Kur përmendet vetëm Allahu, zemrat e atyre që nuk besojnë në jetën tjetër neveriten, ndërsa, kur përmenden të tjerët, përveç Allahut, ata menjëherë gëzohen.”

39-Zumer: 45

³⁸ Ahmedî dhe Taberani nga Esved ibn Seri.

Ai që të brendshmen e vet nuk e pastron nga mjeti, dhe nuk e njeh vetëm si mjet, e fshehta e tij (*sirr*) sikur të mos jetë i shpëtuar nga shirku i fshehtë. Prandaj duhet të frikësohet nga Allahu në pastrimin e tevhidit të tij nga njolla dhe era e shirkut.

Cilësia e katërt: ai të cilit i jepet sadakaja duhet të mos ankohet për gjendjen e vet, të jetë razi me gjendjen e vet dhe të fsheh nevojën e vet. Duhet të jetë prej atyre që posedojnë burrëri, dhe që, edhe kur privohen nga mirësitë, mbesin të tillë çfarë kanë qenë. Ai duket i pasur, por pas perdes jeton i varfër. Allahu Teala thotë:

“Kush nuk e di gjendjen e tyre mendon se ata janë të pasur. Ata i njeh nga vetë pamja e tyre (e rraskapitur), por nuk kërkojnë e as nuk i mërzhitin njerëzit.” (2-Bekare: 273), pra, ata nuk kërkojnë me këmbëngulje sepse janë të pasur me besim të fortë, prandaj edhe janë të durueshëm dhe të dinjitetshëm.

Ja, njerëz të këtillë të fesë të zbukuruar me perden e virtytshmërisë duhet kërkuar kur jepet sadakaja. T’ju jepet të këtillëve është sevap shumë më i madh se sa t’ju jepet atyre që kërkojnë haptas.

Cilësia e pestë: pranuesi i sadakasë të mbajë familje, ose të jetë i penguar në këtë me sëmundje ose ndonjë arsye tjetër, përshtatshëm fjalëve të Allahut Teala:

“(Jepni) për të varfërit që janë të angazhuar në rrugën e Allahut dhe nuk janë në gjendje të udhëtojnë (për të fituar).” (2-Bekare: 273),

pra, që në rrugë të ahiretit janë të penguar me sëmundje, situatë të vështirë ose me përmirësim të zemrës, që nuk mund të ecin nëpër tokë sepse krahët i kanë të prerë e gjymtyrët të prangosura.

Për këto arsye, Omeri r.a., e kishte zakon që Ehli-bejtit t’i ndajë një kope delesh, prej dhjetë a më shumë dele.

Edhe Resulallahu, s.a.v.s., dhuronte sipas madhësisë së familjes. E pyetën një herë hazreti Omerin, r.a., për gjendjen e vështirë, e tha: *“Shumë fëmijë, e pak pasuri.”*

Cilësia e gjashtë: të jetë i afërt dhe akraba, e kështu sadakaja shërben edhe për forcim të lidhjeve familjare, e në lidhjet familjare ka sevap që as nuk mund të përshkruhet.

Alia, r.a., ka thënë: *“Për mua më e dashur është t’ia jap një derhem vëllaut ose një miku, se sa t’ia jap njëzet derhemë dikuj tjetër, më e dashur është t’ia jap njëzet derhemë vëllaut, se sa të jap njëqind derhemë të tjerëve, më e dashur më është t’ju jap vëllezërve njëqind derhemë se sa të liroj një skllav.”*

Siç kanë përparësi akrabatë ndaj të huajve, edhe shokët dhe vëllezërit nga feja kanë përparësi ndaj të huajve. Duhet pasur kujdes për këto gjëra.

Të gjitha këto cilësi kërkohen dhe secila prej tyre i ka gradat e veta. Duhet kërkuar grada më e lartë, e sikur t'i arrinte të gjitha, eh, kjo do të ishte sukses i vërtetë! Sado që të mundohet e t'ia qëllojë, do të ketë shpërblim të dyfishtë, e nëse ka gabuar, i mbetet një shpërblim. Një prej shpërblimeve është pastrimi i tij nga cilësia e koprracisë, forcimi i dashurisë së Allahut në zemër dhe angazhimi për nënshtrim Allahut.

Këto janë cilësi që vendosen në zemrën e tij dhe ia ngjallin dëshirën për takim me Allahun Teala. Shpërblimi i dytë ka të bëjë me dobinë që ky e ka nga duaja e pranuesit të sadakasë. Zemrat e të mirëve (*el-ebrrar*) lëjnë gjurmë edhe tash edhe në ardhshmen. Nëse gjen të tillë që i posedojnë këto cilësi për sadakanë, atëherë i ka të dy shpërblimet, e nëse nuk gjen, përfiton një shpërblim, e Allahu Teala e di më së miri!

Kapitulli i tretë

CILËSITË E ATYRE QË E MERITOJNË ZEKATIN DHE DETYRAT E TYRE NË RASTIN E PRANIMIT

Dije se, zekat i jepet tetë kategorive të përmendura në Kur'ani Kerim (9-Teube: 60). Zekati i jepet myslimanit të lirë, e nuk mund t'i jepet pabesimtarit, as skllavit, e as dikujt nga soji i Hashimive apo Muttalibëve. Sa për fëmijën dhe të çmendurin, atyre lejohet t'ju jepet zekat, nëse e merr kujdestari i tyre. Tani t'i shpjegojmë këto tetë kategori:

Kategoria e parë: *fukaratë*

Fukara është ai që nuk posedon kurrfarë pasurie dhe që nuk ka mundësi ta fitojë. Nëse ka ushqim për një ditë dhe rroba veshur, nuk është fukara, por është i gjerë (*meskin*) Nëse ka ushqim për vetëm gjysmë dite, prapë llogaritet fukara. Nëse ka këmishë, e nuk ka peshkir, këpucë e brekë, e vlera e këmishës nuk do të ishte më e madhe se të gjitha këto, ashtu siç edhe i takon fukarasë, në atë rast llogaritet si fukara sepse për momentin nuk e ka atë për të cilën ka nevojë dhe nuk është në gjendje ta sigurojë. Që dikush të jetë fukara, nuk është kusht që të ketë rroba vetëm sa për të mbuluar pjesët e turpshme. Kjo vërtetë do të ishte teprim.

Një person i tillë është vështirë të gjendet. Fakti se i është lëshuar lypësarisë nuk e largon nga kategoria e fukarasë, sepse lypësaria nuk llogaritet fitim. Por nëse edhe fiton diçka (përpos lëmoshës), kjo do ta largonte nga kategoria e fukarasë. Nëse është në gjendje të fitojë me ndihmën e mjeteve, e mjetet nuk i ka, atëherë i lejohet t'i blejë ato mjete. Nëse mund të fitojë me diçka që është nën nderin e tij, edhe i tilli llogaritet fukara.

Nëse është dijetar, të cilin angazhimi për fitim do ta largonte nga dituria, edhe i këtilli llogaritet fukara, pa marrë parasyshë që ai është në gjendje të fitojë. Dijetarit të tillë mund t'i jepet zekati. Por, nëse është i devotshëm të cilin angazhimi në fitim do ta largonte nga ibadetet e shumta nafile dhe virdet, në atë rast ai duhet t'i braktisë ibadetet nafile dhe të angazhohet për të fituar, sepse angazhimi për fitim është më i vlefshëm se sa ibadetet nafile. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kërkimi i hallallit është farz mbi farz.”³⁹

Me **“farz mbi farz”**, mendohet në angazhimin për fitim. Omeri, r.a., ka thënë: *“Fitimi (edhe nëse është) i dyshimtë është më i hairit se sa të kërkohet lëmoshë.”*

³⁹ Taberani dhe Bejheki nga Ibn Mesud.

Gjithashtu, ai për të cilin kujdeset prindi, ose i mjafton ndihma nga dikush që e ka marrë për obligim ta nihmojë, edhe pse kjo është gjendje e papëlqyeshme, prapë ai nuk konsiderohet fukara.⁴⁰

Kategoria e dytë: *të gjoburit (el-mesakin)*

Meskin; është ai të cilit të ardhurat nuk ia mbulojnë harxhimet. Prandaj, dikush mund t'i ketë edhe njëmijë derhemë, e të llogaritet si meskin, e mund të ketë vetëm një sëpatë e një litar, por me këto fiton për jetë dhe llogaritet i pasur. Shtëpia ku jeton dhe rrobat që i veshë sipas gjendjes, nuk e privon nga statusi i të varfrit (meskin). Njëjtë edhe me mobilitet e shtëpisë, pra me ato që i përdorë dhe që i përshtaten.

Njëjtë, edhe posedimi i librave të fikhut nuk e privon nga statusi i meskinit. Po të mos posedonte asgjë tjetër pos librave, atëherë nuk e ka obligim të japë sadakanë e fitrit. Librat kanë status të njëjtë si edhe rrobat dhe gjërat e domosdoshme për shtëpi, që i nevojiten. Megjithatë, duhet pasur kujdes në kuptimin e nevojës për librat. Pra, libri përdoret për tri arsye: për të mësuar, për të nxjerrë dobi dhe leximi për dëfrim.

⁴⁰ Sipas medh'hebit Hanefi nëse nuk posedon asgjë, është i vërfër, pra nëse babai është i pasur, e fëmija nuk posedon asgjë, atëherë babai i pasur mund t'ia jep zekatin fëmijës së varfër.

Kjo e fundit nuk merret parasysh, dhe i përfshinë librat me poezi, histori dhe libra tjerë prej të cilave nuk ka dobi në ahiret, e në dynjallëk shërbejnë vetëm për dëfrim. Libra të këtillë mund të shiten për *kefaret* dhe për sadakanë e fitrit, prandaj ai që posedon këso libra nuk llogaritet meskin.

Sa për libra që nevojiten për mësim, nëse është me qëllim të fitimit, si për shembull te edukatori, mësuesi ose profesori, për një pagë të caktuar, atëherë ato janë vegla të tyre dhe nuk shiten për të dhënë sadakanë e fitrit, njëjtë si mjetet e ndonjë rrobaqepësi ose cilit do tjetër zejtar. Nga ana tjetër, nëse jep mësim në diçka që është farzi-kifaje, prapë nuk i shet librat për ta dhënë fitrin dhe nuk llogaritet meskin, sepse këto libra janë jashtëzakonisht të nevojshme.

Sa për nxjerrje të dobisë dhe mësimin nga librat, për shembull; kur mbledh literaturë mjekësore që ta shërojë veten, ose libra me vaz, ose që të mësojë gjëra të ndaluara; nëse në atë qytet ka mjek dhe vaiz atëherë ky nuk ka nevojë për këto, e nëse nuk ka mjek a vaiz - atëherë ka nevojë.

Nganjëherë ndodh që një libër do ta lexojë pas një kohe të gjatë, prandaj duhet të caktohet koha përshtatshëm nevojës.

Më e drejta në përcaktimin e periudhës së nevojës është vlerësimi për një vit. Nuk ka nevojë për libra që gjatë vitit nuk do t'i lexojë.

Nëse ushqimin e llogarisim në baza ditore, atëherë nevojat e shtëpisë dhe rrobat duhet llogaritur për një vit. Kështu, nuk duhet shitur rrobat e verës në dimër, as librat për rroba, e njëjtë edhe me mobiljet. Por, nëse i ka dy kopje të librit të njëjtë, atëherë njëra nuk i duhet. Nëse thotë se njëra është më e saktë e tjetra më e bukur, prandaj i duhen të dyja, do të themi: *“Shite më të bukurën, mbaje të saktën.”*

Nëse i ka dy libra nga disciplina e njëjtë e diturisë, njëri përmbledhje e tjetri më i hollësishëm, dhe nëse e ka për qëllim të përfitojë prej tyre, le ta mbajë të dytën, e të parën ta shesë. Por, nëse qëllim e ka të mësojë të tjerët, atëherë mund t'i mbajë të dyja, sepse secila ka diçka që tjetra nuk ka.⁴¹ Shembujt e këtyllë janë të pafund, e dituria e fikhut nuk merret me to. Ne i përmendëm vetëm si parim i përgjithshëm për të shpjeguar nevojën, dhe duke i shikuar nga aspekti pozitiv.

⁴¹ Sipas medh'hebit Hanefi, nuk ka zekat për libra që nuk janë për tregti, por libra jo aq të nevojshme llogaritet sadakul-fitri.

Vlerësimi i të gjitha këtyre formave është i pamundur, sepse marrja e një detyre të tillë kërkon, për shembull, te mobilitet – caktimin e çmimit të tyre, sasisë dhe llojit, si edhe te rrobat, ose te shtëpia – hapësirën e saj. Të gjitha këto është vështirë të definojnë saktë. I takon secilit fakih që sipas logjikës së vet të caktojë parametrat duke dhënë definicionin më të përafërt ashtu si mendon vet, e duke u ruajtur nga rreziku i dyshimit.

I devotshmi do t'i mbahet asaj që është e sigurt e do të largohet nga ajo që sjell dyshim. Grada të mesme, që gjenden mes skajshmërive të qarta të kundërta mes vete, vërtetë ka shumë, e nga to mund të shpëtohet vetëm me kujdes të shtuar. E Allahu Teala e di më së miri!

Kategoria e tretë: *ata që e mbledhin zekatin (el-amilun)*

Këta janë personat që mbledhin zekat, përpos halifes e kadisë, e përfshinë drejtuesin, shkruesin, mbledhësin, ruajtësin dhe bartësin. Të gjithë paguhen njësoj. Nëse mbetet diçka nga zekati që është ndarë për ta, ndahet në kategoritë tjera njësoj, e nëse mungon diçka, atëherë kompenzohet nga buxheti i shtetit.⁴²

⁴² Sipas medh'hebit Hanefi, ai që mbledh zekatin (*amil*) merr nga këto para, por kjo nuk është zekat, është pagë, prandaj edhe *amili* i pasur që nuk është Hashimi mund t'i marrë këto para.

Kategoria e katërt: *atyre që duhet përfituar zemrat për islam* (muellafetu'l-kulub).

Mendohet në elitën (e ndonjë populli, fisi ose bashkësie), që e kanë pranuar islamin e populli i dëgjon, ata do të forcoheshin në islam nëse u jepet zekati, e kjo do të ishte edhe nxitje për të ngjashmit me ta dhe për pasuesit e tyre.

Kategoria e pestë: *për lirim nga skllavëria (mukateb)*

Mukateb: do të thotë skllavi që do të lirohet me para. Pronari thotë: “*më sjell kaq para, e unë të liroj*”. Një zavalli të tillë, i cili mund ta blejnë veten, i jepet zekat. Zekat mund ta japë edhe pronari, në llogari të skllavit për borxhet që skllavi mund t'i ketë. Mirëpo, pronari nuk ia jep zekatin skllavit që do ta lirojë, sepse skllavi ende llogaritet pronë e tij.

Kategoria e gjashtë: *kategoria e borxhlive (el-garimun)*

I tillë është ai që ka marrë borxh për vepër të mirë ose të lejuar (*mubah*), e nuk mund ta paguajë borxhin. Nëse ka borxh për diçka jo të mirë, nuk i jepet zekati, përpos nëse pendohet. Zekati nuk i jepet as të pasurit që ai ta paguajë borxhin, përpos nëse ka hyrë në borxh për ndonjë të mirë të përgjithshme, ose për pengimin e fitnes (ngatërresës).

Kategoria e shtatë: *Luftëtarët në rrugën e Allahut.*

Luftëtarëve të cillëve nuk ju sigurohet paga nga ushtria, edhe nëse janë të pasur, u jepet zekati, e kjo do t'ju jetë ndihmesë e mirë në luftën e tyre.

Kategoria e tetë: *kategoria e udhëtarëve*

Udhëtar ose mysafir, që është larguar nga atdheu i vet, por jo për vepra të këqija. Të tillit, nëse është fukara, mund t'i jepet nga zekati, e nëse posedon pasuri në vendin e vet, atëherë do t'i jepet aq sa i duhet të arrijë në vendin e vet.

Nëse ti pyet se si mund të njihen këto cilësi, ne themi:

“Sa për të gjobët dhe të varfrit (el-fakr vel-meskene), ato llogariten sipas deklaramit të atij që e pranon zekatin, e nuk kërkohet dëshmi e veçantë apo përbetim, por do të mbështeten në deklaramin e tyre, nëse dihet se nuk janë gënjeshtarë. Luftimi dhe udhëtimi janë të ngjashëm, sepse këto janë ngjarje të ardhshme. Nëse dikush thotë se është luftëtar ose udhëtar, atij i jepet zekati, por nëse nuk është në front, ose nuk është nisur për në udhëtin, atëherë zekati që i është dhënë, i merret. Tek të gjitha kategoritë tjera, nevojitet dëshmia.”

Pra, këto ishin kushtet për të merituar zekatin. E sasinë e zekatit dhe sadakasë që e meritojnë këto kategori do t'i shpjegojmë më vonë.

DETYRAT E ATIJ QË E PRANON ZEKATIN

Këto detyra janë pesë:

E para: të jetë i vetëdijshëm se Allahu Teala dhënien e zekatit e ka bërë farz, t'i plotësojë nevojat e veta dhe të drejtojë vëmendjen në një pikë. Zaten, dëshira e Allahut Teala prej njerëzve është që preokupim i tyre të jetë vetëm Ai dhe ahireti. Pikërisht ky është edhe kuptimi i fjalëve të Allahut Teala:

“Xhindët dhe njerëzit i kam krijuar vetëm që të Më adhurojnë.” 51-Dharijat: 56

Por, pasi që ka qenë *hikmeti Allahij* (urtësi hyjnore) që robët t'i ngarkohen epshe dhe nevoja edhe nëse këto nevoja i'a shpërndajnë mendimet, prapë mirësia e Allahut deshi që t'i ofrojë nimete që do t'i plotësojnë këto nevoja të tij. Allahu Teala robëve të Tij ju dhuroi pasuri të mjaftueshme, duke ua plotësuar kështu nevojat, që ata të bëjnë ibadet në qetësi shpirtërore. Ai ia shtoi pasurinë disave, e ata e futën veten në rrezik, deri sa të tjerët i ruajt nga dynjallëku ashtu siç kujdeset njeriu për familjarin e vet të sëmurë. Allahu Teala i privon ata nga luksi i dynjasë, e përmes duarve të pasanikëve ju jep sa ju duhet, që të kenë fitim të lehtë, e të pasurve ju mbetet mundimi për fitim dhe ruajtje të pasurisë.

Përfitojnë pikërisht fukaratë, sepse angazhohen në ibadet dhe bëhen gati për jetën pas vdekjes. Atyre, pasuria e dynjasë nuk ua tërheq vëmendjen, e as varfëria nuk i ndalon nga këto përgatitje. Pra, ky është kufiri i fundit i nimetit. Obligim i fukarasë është ta njohë vlerën e varfërisë dhe ta kuptojë që virtytet që ia dhuroi Allahu Teala janë më sipëror se sa mirat materiale që e largojnë prej Tij. Inshallah këto çështje do t'i shpjegojmë në librin për varfërinë (*kitabu'l-fakr*)

Prandaj, atë që e merr nga Allahu nëpërmjet të pasurit, le ta merr si furnizim dhe ndihmesë për ibadet, dhe kur merr, nijet le ta ketë zbatimin e urdhrave të Allahut Teala. Nëse për këtë nuk është në gjendje, atëherë le ta harxhojë në diçka që Allahu Teala e ka lejuar. Nëse atë që e merr e harxhon në gjëra ndaluara, atëherë do të ishte mohues i mirësive të Allahut dhe do të meritonte largim nga rahmeti i Tij dhe urrejtjen e Tij.

E dyta: të falënderojë dhuruesin, të bëjë dua për të e ta lavdërojë, me ç'rast nuk duhet që dhuruesin ta kuptojë ndryshe pos si ndërmjetës dhe ta shohë si mjet për arritjen e nimetit të Allahut. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kush nuk është falënderues ndaj njerëzve, nuk është falënderues as ndaj Allahut.”⁴³

⁴³ Tirmidhi nga Ebu Seid, Ebu Davud e Ibn Hibban nga Ebu Hurejre.

Allahu Teala i lavdëron robët e Tij për veprat, ani pse Ai i krijoi edhe veprat edhe forcën për t'i bërë ato, dhe thotë:

“Sa rob shumë i mirë ishte ai dhe i kthyer te Zoti.”

38-Sad: 44

Prandaj, ai që pranon sadaka në dua për dhuruesin duhet të thotë: *“Allahu ta pastroftë zemrën e ta bëftë prej zemrave të të mirëve, veprimin tënd e bëftë prej veprimeve të të zgjedhurve, dhe ta bëftë rahmet edhe shpirtin tënd së bashku me shpirtat e shehidëve.”*

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kush ju jep një dhuratë, shpërblejeni, e nëse për këtë nuk keni mundësi, atëherë bëni dua për të deri sa të jeni të sigurt se e keni shpërblyer!”⁴⁴

Pjesë e falënderimit është edhe fshehja e mangësive të mundshme të dhuratës, nëse nuk i jep diçka të mos e nënçmojë, qortojë as turpërojë edhe kur është vet edhe kur është mes njerëzve. Detyrë e dhuruesit është që dhuratën ta konsiderojë të pakët, e detyrë e pranuesit është falënderimi dhe ta konsiderojë dhuratën si të madhe. Secili duhet ta kryej obligimin e vet, sepse dhuruesi, dhuratën e konsideron të pakët nga një aspekt tjetër, ndërsa pranuesi e konsideron si të madhe nga një aspekt tjetër.

⁴⁴ Ebu Davud dhe Nesai nga Ibn Omeri.

Për dhuruesin është më e dobishme ta konsiderojë të pakët dhuratën, përndryshe ka vetëm dëm. Te pranuesi është e kundërta, ndërsa e gjitha kjo nuk është në kundërshti me kuptimin se nimeti vjen prej Allahut Teala. Ai që ndërmjetësin nuk e sheh vetëm si ndërmjetës, është xhahil. Të konsiderohet ndërmjetësi si burim është mohim i papëlqyer.

E treta: të ketë kujdes çka po pranon; nëse është diçka që nuk është hallall, duhet të largohet nga ajo. Allahu Teala thotë:

“Atij që i frikësohet Allahut, Ai do t’i gjejë rrugëdalje (nga çdo vështirësi).” 65-Talak: 2, 3

Atij që ikë nga harami, Allahu Teala ia hapë derën e hallallit. Kështu, nuk duhet marrë nga populli mizor, ushtria e mizorit, nëpunësit e sulltanit dhe nga ata që shumicën e pasurisë e fitojnë haram, përpos nëse vërtetë është ngusht dhe për pasurinë që jepet nuk dihet pronari i vërtetë; në atë rast i lejohet të merr vetëm aq sa ka nevojë dhe vetëm nëse nuk është në gjendje të gjej hallall. Fetvaja e sheriatit për këtë çështje është se një pasuri e tillë duhet dhënë për sadaka, siç do ta shpjegojmë në *Librin për hallallin e haramin*. Me pranimin e këtyre parave nuk llogaritet që e ka marrë zekatin, sepse atij që jep paratë haram, kjo nuk i llogaritet si zekat.

E katërta: të ruhet nga dyshimi dhe telashet në sasinë e pranuar. Mos të marrë më shumë se që është e lejuar dhe vetëm pasi të jetë i sigurt se i takon. Nëse nuk i takon sadakaja, pra nuk hyn në njërën nga tetë katëgoritë që i përmendëm, nuk duhet ta merr assesi. Nëse merr për lirim të skllavit ose për ta paguar borxhin, atëherë nuk duhet të marrë më shumë se sa është ajo shumë. Nëse punon në mbledhjen e zekatit (*amil*), duhet të marrë njësoj si puntorët tjerë. Nëse i jepet më shumë, duhet kërkuar falje e të mos e pranojë, sepse, në esencë, pasuria edhe nuk i takon dhuruesit, e që ai ta shpërndajë si të do ai vet. Nëse është udhëtar, nuk do të marrë më shumë se sa furnizimi për rrugë dhe të domosdoshmet deri në vendin për ku po udhëton. Nëse është luftëtar, do të marrë vetëm atë që i duhet për luftë; kalë, armë dhe të nevojshmet tjera. E gjitha kjo do të përcaktohet sipas vlerësimit (*ixhtihad*) personal. Nuk ka ndonjë kufi të veçantë. Njëjtë edhe te udhëtari, e është pjesë e devotshmërisë të refuzojë atë që mund ta fusë në dyshime.

Nëse pranon si meskin, së pari duhet të shikojë mobilitet në shtëpinë e vet, rrobat dhe librat e veta; a ka mes tyre diçka që nuk i duhet vërtetë, ose nuk i duhen gjëra aq të shtrenjta, dhe atë ta ndërrojë me më të lira, e ndryshimin në para ta harxhojë për plotësim të nevojave të veta.

E gjitha kjo varet nga vlerësimi i tij personal, ku ka dy gjendje të kundërta mes vete: një e vetëkuptueshme, ku shihet se dikush plotësisht e meriton t'i jepet sadakaja, dhe e dyta, kur assesi nuk e meriton. Në mes tyre janë pjesët e dyshimta. Kush luan me zjarr, mund edhe të djeget, edhe kush i afrohet dyshimit, mund të bjerë në haram.

Në të gjitha këto çështje duhet mbështetur në fjalët e pranuesit dhe deklarimi i tij të merret si kriter.

Gradat e vlerësimit të nevojës sipas mjaftueshmërisë, për nevojliun nuk kanë fund. Personi i devotshëm do të përpiqet t'i zvogëlojë nevojat e tij, e ata që nuk mjaftohen i shtojnë ato, bile e konsiderojnë veten nevojli për lloj-lloj gjërash, e që me shariat është e papëlqyer. Në fund, kur nevoja e tij vërtetohet, nuk duhet marrë shumë, por vetëm sa të mbulojë nevojat për një vit. Ky është kufiri i skajshëm i lehtësimit, sepse të ardhurat ripërtërihen çdo vit.

Edhe Resulallahu, s.a.v.s., mbledhte për familjen e vet ushqim vetëm sa mjafton për një vit.⁴⁵ Nëse kufizohet në nevojat për një muaj, bile edhe vetëm një ditë, kjo do t'i ishte më afër takvallëkut.

⁴⁵ Muttefekun alejhi.

Mendimet e dijetarëve ndryshojnë për atë se sa prej zekatit e sadakasë mund të merret. Disa e theksojnë minimumin, sa thonë se mund të merret vetëm aq sa i mjafton për ushqimin e një dite, sipas transmetimit nga Sehl ibn Hanzal, ku thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., e ndaloi lypjen, kur ka. Më vonë e pyetën se sa është shuma që të konsiderohet se ka, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

“Dreka dhe darka.”⁴⁶

Të tjerë thonë se mund t’i marrë të gjitha deri te kufiri i pasurisë, e kufiri i pasurisë është nisabi i zekatit. Sepse Allahu Teala ua caktoi zekatin vetëm pasanikëve, dhe thonë se mundet që për vete dhe për secilin anëtar të familjes së vet të marrë shumë deri një nisab. Të tjerët thonë se kufiri i pasurisë është pesëdhjetë derhemë argjend ose kjo vlerë në ari, sipas transmetimit të Ibn Mesud se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush kërkon, e ka pasuri të mjaftueshme, në ditën e Kijametit do të vijë i shpërfytyruar.”

- *Sa është e mjaftueshme?*; pyetën, e Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- ***Pesëdhjetë derhemë argjend, ose kjo vlerë në ari.***⁴⁷

⁴⁶ Ebu Davud dhe Ibn Hibban.

⁴⁷ Ebu Davud, Nesai, Tirmidhi dhe Ibn Maxhe.

Disa thonë se shkalla e kësaj është katërdhjetë dërhëmë, sipas një transmetimi të ndërprerë nga Atta ibn Jesar, ku thuhet se Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kush lypë dhe i ka katërdhjetë dërhëmë, anon kah lypësaria.”⁴⁸

Disa shkuan edhe më larg e thanë se fukaraja mund të marrë aq zekat sa të mund të blejë vegël dhe materiale për punë, e kështu të shpëtojë nga lypësaria për gjithë jetën, ose aq sa do t’i mjaftojë të fillojë tregti që do t’a sigurojë deri në fund të jetës, sepse të tillët konsiderohen të pasur. Omeri, r.a., ka thënë: *“Njeriun, të ciit i jep, bëje të pasur!”* Bile disa kanë thënë se personi që është varfëruar mund të marrë zekat aq sa ka pasur dikur, edhe nëse dikur i ka pasur dhjetë mijë dërhëmë, por nuk duhet të kalojë kufirin e maturisë. Tregohet se Ebu Talha Ensari falej në bahçen e vet, dhe u mahnit nga një turtulleshë që po fluturonte nëpër degë, duke kërkuar dalje. E përcolli një kohë me shikim, dhe harroi sa reqate i ka falur, e më pas ia tregoi këtë ngjarje Resulallahut s.a.v.s., dhe tha:

- *O Resulallah këtë bahçe e jap sadaka, e ti ndaja kujt të duash*, e Resulallahu s.a.v.s., i tha:

- *Dhuroja akrobave tu; ashtu është më mirë për ty*⁴⁹,

⁴⁸ Ebu Davud dhe Nesai nga Atta.

⁴⁹ Është përmendur në *Librin për namazin*.

e ky ia dhuroi këtë bahçe të madhe me hurme akrobave të vet, Hassanit dhe Ebu Katades. Tregohet se Omeri r.a. ia dhuroi një beduini devenë e vet, bashkë me të voglin e saj. Këto tregime janë shembuj për këtë çështje.

Sa për ushqim për një ditë ose një okë ushqim/ose sasia deri katërdhjetë derhemë , kjo është përmendur në kontekst të mospëlqimit të lypësarisë dhe këkimit derë më derë. Ai që posedon kaq, ose këtë mund ta fitojë, e ka të ndaluar të kërkojë lëmoshë dhe për këtë ka një gjykim tjetër; pra, nisabi i lypësarisë është tjetër, e nisabi i pranimit të zekatit, tjetër. Kjo është shkalla më e ulët. Për atë që dijararët e Irakut thanë se fukaraja mund të marrë aq zekat sa të mund të shpëtojë nga lypësaria për gjithë jetën, kjo është pak e mundur dhe gjithashtu është afër harxhimit të panevojshëm.

Më së afërti maturisë është pranimi për një vit. Gjithçka përtej kësaj është rrezik, e më pak se kaq është e pamjaftueshme. Siç shihet, sheriatu nuk ka një gjykim të prerë në këto çështje, e transmetimet janë të ndryshme. Prandaj *muxhtehidi* sjell vendimin, më së miri që di. Por ai që largohet nga harami, le të përkujtohet për atë që e ka thënë Resulallahu, s.a.v.s.:

“Sado që të japin fetva, ti këshillohu me zemrën”⁵⁰,

⁵⁰ Është përmendur në *Librin për diturinë*.

dhe:

“Dridhja e zemrës është gjynah.”⁵¹

Kur merr diçka, le t’i frikësohet Allahut, e mos t’i afrohet gjërave të dyshimta. Nuk duhet të kërkojë zgjidhje duke u bazuar në fetvatë e dijetarëve zahir, sepse në fetvatë e tyre ka disa kushte të domosdoshme, ka parashikim dhe gjëra të dyshimta, e rujtja nga të dyshimtat është cilësi e besimtarëve dhe adet i udhëtarit në rrugë të ahiretit (*salik*).

E pesta: ai që merr zekat ta pyesë atë që jep zekat se sa do të japë. Sasia më e vogël është 1/8, e nëse jep më shumë se 1/8, duhet ta refuzojë, sepse zekati është e drejta e përbashkët e tetë kategorive, dhe duhet të ndahet në mënyrë të barabartë.⁵² Edhe 1/8 duhet të jetë për tre njerëz nga e njëjta kategori, pra duhet ndarë në tri pjesë të barabarta. Shumica e njerëzve duhet të pyesin dhe t’i mësojnë këto. Megjithatë, ata nuk kanë kujdes në këso ndarje, qoftë nga padituria apo nga pranimi lehtë i gjërave. Inshallah në librin “*Hallalli dhe Harami*” do t’i shpjegojmë më hollësishtëm gjërat për të cilat duhet të pyetet si edhe gjërat që ka mundësi të jenë haram.

⁵¹ Bejhaki nga Ibn Mesudi.

⁵² Sipas medh’hebit Hanefi tërë zekatin mund t’ia japë një kategorie.

Kapitulli i katërt

PËR SADAKANË VULLNETARE, VLERËN E SAJ DHE EDEBI I PRANIMIT DHE DHËNIES SË SAJ

VLERAT E SADAKASË

Nga hadithet, do të përmendim si vijon:

“Jepeni sadakanë, qoftë edhe një hurme. Ajo do t’i mjaftojë të uriturit dhe ia fshinë gabimet ashtu si uji që e fik zjarrin.”⁵³

“Ruajuni nga zjarri i xhehenemit qoftë edhe me gjysmë hurme, e nëse as kaq nuk mundeni, atëherë së paku me një fjalë të mirë.”⁵⁴

“Kushdo që jep një sadaka nga hallalli, qoftë edhe një hurme, Allahu me dorën e fuqisë së Tij e pranon këtë hallall, dhe ashtu si ju që e rritni devenë e vogël, Allahu e rrit atë hurme - sa mali Uhud, dhe ditën e kijametit ia kthen dhuruesit.”⁵⁵

⁵³ Ibnul-Mubareknë *‘Zuhd’*

⁵⁴ Muttefekun alejhi.

⁵⁵ Muttefekun alejhi. E shënojnë edhe Tirmidhi dhe Nesai.

Një herë, Resulallahu, s.a.v.s., i tha Ebu Derdasë:

“Kur të ziesh çorbë, shto pak më shumë ujë, dhe kujdesu që nga ajo t’i ndashë edhe komshive tu (që janë nevojtare).”⁵⁶

“Kush do që jep sadakanë në mënyrën më të bukur, (pra nga hallalli, me fytyrë të qeshur, me gjuhë të ëmbël) Allahu Teala do t’i japë pasardhës të hajrit.”⁵⁷

“Secili (në ditën e kijametit) do të jetë nën hijen e sadakasë së vet deri sa njerëzve t’ju gjykohet.”⁵⁸

“Sadakaja i mbyllë shtatëdhjetë dyer të sherrit.”⁵⁹

“Sadakaja e fshehtë e zbut zemërimin e Allahut.”

“Shpërblimi i atij që jep sadakanë nga pasuria e vet nuk është më i vlefshëm se shpërblimi i atij që e pranon atë sadaka nga nevoja.”⁶⁰

Me siguri mendohet në atë i cili me plotësimin e nevojës synon kthimin në ibadete. Me këtë ai është i njëjtë me dhuruesin e sadakasë, që me dhurim ka për qëllim forcimin e fesë së vet.

⁵⁶ Muslimi nga Ebu Dherr.

⁵⁷ Ibn’l Mubarek, në **‘Zuhd’**

⁵⁸ Ibn Hibban

⁵⁹ Ibnu’l-Mubarek nga Enesi.

⁶⁰ Ibn Hibban në **‘Dhuafa’**

Kur pyetën:

- *O i Dërguari i Allahut, cila sadaka është më e vlefshme?*, Resulallahu, s.a.v.s., tha:

- **Të japësh sadaka kur të jesh i shëndoshë e koprrac, e frikësohesh nga varfëria, dhe e dëshiron pasurinë. Mos e vono këtë gjer kur të vije shpirti në fyt, e atëherë të thuash: “Jepjani këtë atij dhe këtë atij tjetrit”, ndërsa kjo qysh më herët ka qenë e tij.”⁶¹**

Një herë, Resulallahu, s.a.v.s., ju tha as’habëve të tij:

- **Jepni sadakanë!** Në këtë, një person tha:

- *Unë e kam një dinar.*

- **Harxhoje për vete!**, tha Resulallahu, s.a.v.s..

- *E kam edhe një tjetër*, tha personi.

- **Harxhoje për gruan tënde!**, tha Resulallahu, s.a.v.s..

- *Kam edhe një!*, tha personi.

- **Harxhoje për fëmijën tënd!**, tha Resulallahu, s.a.v.s..

- *Kam edhe një tjetër!*, tha personi.

- **Harxhoje për skllavin tënd!**, tha Resulallahu, s.a.v.s..

- *Kam edhe një!*, tha ai, e Resulallahu, s.a.v.s., i tha:

- **Ti e di më mirë se ku duhet ta japësh.**⁶²

“Sadakaja nuk i është hallall familjes (ehli-bejt) së Muhammedit (a.s.), sepse ajo përbëhet nga papastërtitë e pronës së njerëzve.”⁶³

⁶¹ Muttefekun alejhi, nga Ebu Hurejre.

⁶² Ebu Davud, Nesai, Ibn Hibban dhe Hakimi, nga Ebu Hurejre.

“Jepni nga ushqimi juaj lypsarit, qoftë edhe sa një kokërr sheqeri; largojeni qortimin e tij prej jush.”⁶⁴

“Nëse lypësi është i drejtë, me të vërtetë ka nevojë, ai që e dëbon nuk gjen shpëtim.”⁶⁵

Isa, a.s., ka thënë: *“Shtëpia që e kthen lypsarin të dëshpëruar, melekët nuk e vizitojnë atë shtëpi për shtatë ditë.”*

Resulallahu, s.a.v.s., në dy çështje nuk kërkonte ndihmë nga askush; me dorën e vet përgatiste ujin për abdes të natës, dhe me dorën e vet jepte sadaka. Resulallahu, s.a.v.s., gjithashtu thotë:

“Nuk është miskin (fukara) ai që largohet me një ose dy hurme, me një a dy kafshatë, por miskin i është i ndershëm; ai nuk lyp derë më derë. Nëse dëshironi, lexoni ajetin: “*Ata nuk i mërzhisin njerëzit duke lypur* (2-Bekare: 273)”⁶⁶, dhe gjithashtu thotë:

“Nuk ka mysliman që i falë rroba një myslimani tjetër, e të mos jetë nën mbrojtjen e Allahut Teala deri sa ky në trup të ketë një pjesë të asaj robe.”⁶⁷

⁶³ Muslimi nga Muttalib b. Rebia.

⁶⁴ Ukajli në *‘Dhuafa’*

⁶⁵ Ukajli në *‘Dhuafa’*

⁶⁶ Muttefekun alejhi, nga Aishja r.a.

⁶⁷ Tirmidhi dhe Hakim.

FJALËT E TË MËDHENJVE TË ISLAMIT PËR RËNDËSINË E SADAKASË

Uvre ibn Zubejr tregon: *“Ajshe, r.a., jepte sadaka deri në pesëdhjetë mijë dërhemë, ndërsa shaminë e kokës e kishte të arnuar.”*

Në tefsirin e ajetit:

“Ata janë që për hir të Tij u japin ushqim të varfërve, jetimëve dhe të zënëve robër.” 76-Insan: 8, për shprehjen ‘*ala hubbihi*’, Muxhahidi ka thënë se e ka kuptimin: *“edhe pse vetë janë nevojtarë për ushqim, ia japin ushqimin të varfërve.”*

Omeri, r.a., në dua do të thoshte: *“O Allah, jepi me bollëk të zgjedhurve mes nesh, që ata t’i ndihmojnë nevojtarët mes nesh!”*

Omer ibn Abdul-Aziz ka thënë: *“Namazi të sjell në gjysmë të rrugës, agjërimi të dërgon deri para derës së Sunduesit, (Melik), e sadakaja të futë brenda.”*

Ibn Ebul-Xha’d ka thënë: *“Sadakaja i mbyllë shtatëdhjetë dyer të së keqes. Sadakaja e fshehtë është shtatëdhjetë gradë më e lartë se ajo haptas, e në të njëjtën kohë ua shtrëngon nofullat shtatëdhjetë shejtanëve.”*

Ibn Mesud ka thënë: *“Një person bëri ibadet për shtatëdhjetë vite, e më pas bëri një gjynah të madh (zina) dhe të gjitha veprat iu shkatërruan. Më pas, atij i shkoi një fukara, e ai si sadaka ia dha një somun, dhe Allahu ia fali gjynahun dhe ia ktheu sevapet e ibadeteve nga shtatëdhjetë vitet e kaluara.*

Llukmani i tha djalit të vet: *“Kur të bësh ndonjë gabim, menjëherë jep sadaka!”*

Jahja ibn Muadh ka thënë: *“Nuk njoh grimcë që ka peshë sa të gjitha malet e botës, pos asaj që jepet në sadaka.”*

Abdul-Aziz ibn Ebu Revvad ka thënë: *“Thuhet se tri gjëra janë nga thesaret e xhennetit: fshehja e sëmundjes, fshehja e sadakasë dhe fshehja e vështirësive.”*

Edhe Resulallahu, s.a.v.s., i tha Omer ibnul-Hattabit:

**“Veprat e mira garojnë mes vete, e sadakaja thotë:
- Unë jam më e mira nga të gjitha ju!”**

Abdullah ibn Omer si sadaka jepte sheqer, duke thënë:

- *Allahu Teala thotë:*

“Kurrresi nuk do të arrini mirësinë e lartë, përderisa të mos ndani një pjesë nga ajo që e doni.” (3-Ali Imran, 92),
e Allahu e di sa shumë unë e dua sheqerin.”

Nehai ka thënë: *“Kur jap për rizanë e Allahut, nuk dua që ajo të ketë ndonjë të metë.”*

Ubjed ibn Umejr ka thënë: *“Njerëzit ringjallen në ditën e Kiametit më të uritur se që ishin ndonjëherë, më të etur se që ishin ndonjëherë, më të zhveshur se që ishin ndonjëherë. Ai që ka ushqyer në emër të Allahut, Allahu do ta ngopë; kush ka dhënë ujë për rizanë e Allahut, Allahu do t’i japë ujë, kush ka veshë për rizanë e Allahut, Allahu do ta veshë.”*

Hasan Basri ka thënë: *“Po të dojë Allahu, do t’ju bënte të pasur pa asnjë fukara mes jush, mirëpo Ai ju ka provuar juve me njëri-tjetrin.”*

Sha’biu ka thënë: *“Ai që nuk e sheh veten më shumë në nevojë për sevapin e sadakasë se sa që fukaraja ka nevojë për sadakanë e tij, sadakaja i humb shpërblimin.”*

Imam Malikiu ka thënë: *“Nuk shohim asgjë të keqe që edhe i pasuri të pijë ujë me enën që për këtë qëllim është dhënë sadaka në xhami, sepse ajo është bërë për të eturin, kush do qoftë ai. Ajo nuk është e rezervuar vetëm për fukaratë.”*

Tregohet se pranë Hasan Basrisë kaloi një tregtar me mall, e pranë tij një skllave, e Hasani e pyeti:

- *A do ta jepje për dy dërhëmë?*
- *Jo, u përgjigj tregtari, e Hasani i tha:*
- *Nëse nuk e jep rrugë të mbarë, largohu! Allahu Teala e jep një hyri edhe për një kafshatë!*

SHPJEGIMI I DHËNIES SË ZEKATIT DHE SADAKASË FSHEHTAS DHE HAPTAS

Për ata që kërkojnë sinqeritetin, pikëpamjet në këtë çështje ndahen. Disa anojnë kah ajo se dhënia e fshehtë e sadakasë është më e mirë, e të tjerët thonë se më mirë është që ajo të jepet haptas. Ne do të ndalemi në kuptimin dhe të metat e secilit mendim, e më pas do të largojmë perden nga e vërteta.

Dhënia e sadakasë fshehtas ka pesë kuptime:

Kuptimi i parë: dhënia e sadakasë fshehurazi është më e sigurt për ruajtje të dinjitetit të atij që e pranon. Në dhënien haptas dinjiteti i tij çënohet, nevoja e tij do të zbulohej, e ai do të dilte nga gjendja e vetëpërmbytjes dhe sjelljes së lavdëruar, me të cilën të padijshmit e konsiderojnë të pasur, për shkak të vetëpërmbytjes së tij.

Kuptimi i dytë: sadakaja e fshehtë mbronë nga gjuha dhe mendimet e këqija të njerëzve, dhe i mbronë të dy, edhe atë që jep edhe atë që merr. Njerëzit e xhelozojnë njëri-tjetrin dhe mund të flasin kundër atij që merr duke menduar se është i pasur, ose mendojnë se po merr më shumë se që i duhet.

Kjo hapë rrugë për gjynahe të mëdhaja si lakmia, mendimi i keq dhe thashethëmet. Të ruhen njerëzit nga këto gjynahe është më e rëndësishme. Ebu Ejjub Sahtijani ka thënë: *“Hezitoj të vesh rroba të reja që t’i ikë xhelozisë së komshive të mi”*.

Njëri prej zahidëve ka thënë:

“Braktisa përdorimin e shumë gjërave për shkak të komshive, që të mos shfaqin xhelozin, e të mos thonë: ‘Prej nga i erdhi kjo? Kush ia dha?’”

Tregohet se Ibrahim Tejmisë ia panë veshur një këmishë të re, e njëri prej vëllezërve e pyeti:

- *Ku e more?, e Ibrahim Tejmi tha:*

- *Ma dha vëllau Hajseme, por sikur ta dija që familja e tij nuk dinë për këtë, nuk do ta pranoja.*

Kuptimi i tretë: fshehja e veprimit është ndihmesë për dhuruesin, sepse dhënia e fshehtë është më e vlefshme se sa dhënia haptas, e të ndihmohet personi për ta plotësuar sadakanë dhe mirëbërjen është sadaka dhe mirëbërje.

Sadakaja mund të jetë e fshehur nëse mbetet vetëm në mes të atij që jep dhe atij që merr. Nëse njëri tregon, fshehtësia ndërpritet.

Një person i dha haptas diçka një dijetari, por dijetari nuk e pranoi. Të njëjtit dijetar më vonë dikush tjetër i dha diçka, por fshehtas, e ky e pranoi. E pyetën për arsyen, e tha:

- Ky i dyti, duke respektuar edebin e sadakasë, e dha atë fshehtas, prandaj e pranova, deri sa ai i pari nuk e respektoi edebin e sadakasë, prandaj e refuzova.

Edhe një sufiu dikush i dha haptas sadakanë, por ky e refuzoi, e personi pyeti:

- Pse refuzon çfarë të ka dhuruar Allahu?, e sufiu i tha:

- Me dhënie haptas, ti i bërë ortakë edhe të tjerët në atë që është vetëm e Allahut, prandaj po e refuzoj shirkun tënd.

Tregohet se njëri prej arifëve pranoi fshehtas diçka që më parë haptas e kishte refuzuar. Dhuruesi e pyeti për sebebpin e kësaj, e arifi i tha: *“Kur ma dhurove haptas, ti e bërë për dukje dhe nuk ishe i nënshtruar urdhrave të Allahut, e unë nuk desha të të ndihmoj në atë gjynah. Me dhënien e fshehtë, duke e bërë nijet vetëm rizanë e Allahut, ti i përshtatesh urdhërit të Tij, e unë desha të të ndihmoj në atë mirëbërie duke e pranuar dhuratën.”*

Sufjan Sevri ka thënë: *“Sikur ta dija se ai që jep sadaka nuk do ta përmend këtë e nuk do t’i tregojë askujt, unë do ta pranoja”;*

Kuptimi i katërt: në pranimin e sadakasë haptas ka nënçmim dhe poshtërim, e besimtarit nuk i ka hije që veten t’ia ekspozojë poshtërimit. Një prej dijetarëve merrte fshehtas sadakanë, larg prej publikut. Njëri prej dijetarëve e merrte sadakanë kur ia jepnin haptas, dhe thoshte: *“Dhënia haptas e sadakasë nënçmon diturinë dhe përbuzë bartësit e saj. Prandaj unë nuk pranoj asgjë nga dynjallëku që përlulë diturinë e i përbuzë bartësit e saj.”*

Kuptimi i pestë: pranimi i sadakasë fshehtas ruan nga dyshimi i ortakërisë. Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kujt i dhurohet diçka, e afër tij ka njerëz të tjerë, ata do t’i bëhen ortakë në këtë.”⁶⁸

Dhurata, qoftë argjend apo ar, edhe më tutje është dhuratë. Ndërsa Resulallahu, s.a.v.s., dhuronte argjend, dhe ka thënë:

“Më e mira që personi mund t’ia dhurojë vëllaut të vet (në fe) është argjendi, ose ta ushqejë.”⁶⁹

Shkurtimisht, ajo që jepet haptas është e papëlqyer (mekruh), por nëse pajtohen të dy palët atëherë nuk ka dëm. Megjithatë, prapë ka mundësi për dyshime, e këto dyshime largohen vetëm me dhënie fshehtas.

⁶⁸ Ukajli dhe Ibn Hibban në *‘Dhuafa’*

⁶⁹ Ibn Adijj

Dhënia e sadakasë haptas ka katër kuptime:

Kuptimi i parë: dhënia e sadakasë haptas është më e pëlqyeshme sepse është dëshmi për drejtësinë dhe sinqeritetin e personit dhe e ruan atë nga dyfytësia.

Kuptimi i dytë: në pranimin e sadakasë haptas ka poshtërim, dëmtim të reputacionit dhe pozitës, shfaqje të varfërisë, largim nga mendjemadhësia dhe nënçmim në sytë e njerëzve. Njëri prej dijetarëve i tha nxënësit të vet: *“Nëse pranon sadaka, gjithsesi pranoje atë haptas. Sepse ti do të përfitosh:*

(1) të nënçmojnë njerëzit; që duhet të jetë dëshirë e jotja sepse kjo e ruan besimin tënd; dhe

(2) e përforcon lidhjen me personin, e kjo është çfarë vëllau yt dëshiron prej teje, sepse atij i shtohen sevapet duke e shtuar dashurinë dhe respektin për ty. Atëherë edhe ti do të shpërblehesh që pranimi yt haptas ishte arsye për shtimin e sevapeve të tij.”

Kuptimi i tretë: për dijetarët, si fshehtas si haptas, është njëjtë sepse dijetarët nuk shikojnë tjetër pos Allahut Teala. Ndryshimi i gjendjes për ta është një lloj shirku në tevhid. Prandaj disa prej tyre kanë thënë: *“Ne nuk i japim rëndësi duasë së atij që fshehtas merr e haptas refuzon.”*

Vëmendja se a ka njerëz prezent apo jo dhe nevoja për fjalë të mira lavdëruese prej tyre është dëshmi e ndryshimit të gjendjes.

Shikimi duhet t'i drejtohet vetëm Allahut Teala. Tregohet se një shejh, njërin prej muridëve të vet e donte më shumë se të tjerët. Kjo ju vinte e vështirë muridëve tjerë, prandaj shejhu vendosi t'ju tregojë pse pikërisht atë e do më shumë. Secilit murid ia dha nga një zogëz, e ju tha ta presin diku ku askush nuk do t'i shohë. Të gjithë u kthyen te shejhu dhe secili tregoi se e kishin prerë zogëzën në një vend ku askush nuk i ka parë, përpos atij muridi, i cili u kthye me zogëz të gjallë. Shejhu e pyeti përse edhe ai nuk e kishte prerë zogëzën si shokët e tij, e ai tha:

- *Nuk munda të gjej vend ku nuk do të më shihte Allahu. Kudo që të jem, Ai më sheh; e shejhu tha:*

- *Ja, për këtë e kam zgjedhur atë mes jush; ai nuk shikon në askë, pos në Allahun.*

Kuptimi i katërt: përmes dhënies së sadakasë haptas, shprehet sunneti i falënderimit për nimetin. Allahu Teala thotë:

“dhe mirësitë e Rabbit tënd, shprehi!” 93-Duha: 11.

Prandaj, fshehja do të ishte mosmirënjohje dhe mohim i mirësive, e Allahu Teala e ka qortuar atë që fshehë mirësitë (nimetin) e Allahut, duke e ndërlidhur me koprracinë, dhe thotë:

“Ata që vetë janë koprracë dhe urdhërojnë njerëzit për koprraci, dhe e fshehin atë që ju ka dhënë Allahu nga mirësitë e veta.” 4-Nisa: 37

Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kur Allahu i dhuron robit një nimet të Tij, Ai ka dëshirë që ky nimet edhe të shihet te robi.”⁷⁰

Një person i dha diçka fshehurazi njërit nga të devotshmit, e ky e ngriti dorën e i tha:

- Kjo është nga dynjallëku, e në dynjallëk më mirë është haptas. Fshehtësia është më e mirë për gjërat e ahiretit.

Prandaj dikush ka thënë: *“Kur të jepet diçka haptas, pranoje, e më pas ktheje fshehurazi.”*

Falënderimi për mirësitë (nimet) është inkurajuar; Resulallahu, s.a.v.s., thotë:

“Kush nuk është falënderues ndaj njerëzve, nuk është falënderues as ndaj Allahut Teala.”

Falënderimi e zë vendin e shpërblimit, aq sa Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikush ju bën ndonjë të mirë, shpërblejeni, e nëse nuk mundeni, atëherë dëshironi diçka të mirë dhe lexoni dua deri sa të jeni të sigurt se e keni shpërblyer.”

⁷⁰ Ahmed i nga Imran b. Husejni.

Muhaxhirët e pyetën Resulallahun, s.a.v.s.:

- *O Resulallah, nuk kemi parë njerëz më të mirë se ata tek të cilët po qëndrojmë (ensarët) dhe në pronat e të cilëve kemi hise, aq sa frikësohemi se i gjithë shpërblimi do të shkojë me ta; e në këtë Resulallahu, s.a.v.s., tha:*

- ***Falënderimi juaj ndaj tyre e ka vlerën e shpërblimit.***⁷¹

E tash, kur u njoftove me të gjitha këto kuptime, me lehtësi e kupton se dallimi nuk është në esencë, por në gjendjen (*hal*) dhe situatat e njerëzve.

Largimi i perdes nga kjo çështje është se nuk mundet të thuhet absolutisht që njëra është më mirë se tjetra. Krejt varet nga nijeti, e nijetet ndryshojnë aq sa ndryshojnë gjendjet e njerëzve.

Njeriu i sinqertë duhet të ketë kujdes të mos devijojë, të mos mashtrohet nga natyra e vet e ngatërruar dhe të mos bjerë në hilen e shejtanit. Hile dhe mashtrim ka edhe në pranimin e sadakasë dhe zekatit fshehtas edhe haptas, por ky mashtrim është më shumë prezent në pranimin fshehtas se sa në pranimin haptas të tyre.

Në preferimin e pranimiit fshehtas mashtrimi është kështu:

⁷¹ Tirmidhi

Pasi që në pranimin e sadakasë haptas ka gjendje si poshtërim, dëmtim të reputacionit dhe pozitës, shfaqje të varfërisë dhe nënçmim si edhe për faktin se e gjithë bota e shikon fukaranë me syrin e përbuzjes e dhuruesin si mirëbërës, natyra e njeriut anon kah pranimi i fshehtë. E kjo gjendje është një sëmundje, fshehur në nefsin e njeriut. Përmes kësaj sëmundje, shejtani paraqet përfitimet që i përmendëm në pranimin e fshehtë dhe përpiqet që personi ta preferojë këtë.

Kriter i vlerësimit është që, nëse atij i vije rëndë ta pranojë sadakanë haptas, atëherë duhet njëjtë t'i vije rëndë edhe për tjetrin si vetja, kur e pranon sadakanë haptas.

Nëse qëllimi është të mbrohen njerëzit nga përgojimi (*gibet*), xhelozia (*haset*) e mendimi i keq, ose të mos zbulohen gjendjet e tyre, ose që dhuruesi të mbahet në fshehtësi, ose të mbrohet dituria nga nëpërkëmbja; të gjitha këto janë njëjtë edhe në pranimin e sadakasë haptas nga personi i ngjashëm me të.

Nëse pranimi nga ana e tij i sadakasë do t'i vinte më rëndë se sa pranimi i sadakasë nga dikush tjetër, detyrë e tij është që ta largojë këtë mendim të keq, sepse ky është hile dhe mashtrim i shejtanit.

Nëpërkëmbja është e papëlqyer për vet diturinë, e jo për diturinë e filanit a të fistekut. Njëjtë edhe gibeti është i papëlqyer sepse me të përdhohet nderi i mbrojtur, e jo pse me këtë përdhohet në veçanti nderi i filanit. Ai që e ka kuptuar këtë, mund të ruhet nga kurthet e shejtanit. Në të kundërtën, do të ketë shumë vepra por pak dobi të vërtetë.

Sa i përket dhënies së sadakasë haptas, natyra e njeriut anon në atë drejtim sepse kjo i sjell kënaqësi dhuruesit, i nxitë të tjerët në dhënie të sadakasë, lavdërohet shumë, sa edhe njerëzit tjerë interesohen për gjendjen e tij. E gjithë kjo është sëmundje e brenshme (batin), helm i rrezikshëm që e shkatërron të brendshmen.

Shejtani nuk është në gjendje t'i afrohet personit që ka frikë Allahun pos me plasimin e kësaj shëmtie përmes dyerve të sunnetit, duke i thënë se falënderimi është sunnet, e fshehja është *rijallëk* (dyfytirësi) me çka shejtani ia përkujton përfitimet që i përmendëm.

Kriter i vlerësimit të kësaj është që personi të hulumtojë falënderimin e vet për dhuruesin, i cili nuk do të dijë për këtë, si edhe ai që synon t'i japë diçka, e para tij ka të atillë që dhënia haptas ju është e papëlqyer, që parapëlqejnë dhënien fshehur dhe këtë e kanë adet, pa u falënderuar.

Nëse në të gjitha rastet ka vlerësim të njëjtë, atëherë le ta dijë se motivi i tij duhet të jetë përmbajtja sunnetit në falënderim dhe në të folur për nimetin. Në të kundërtën do të ishte mashtrim. Më pas, nëse e sheh se motiv e ka sunnetin në falënderim, në atë rast nuk do të duhej të harrojë në të drejtën e dhuruesit, por të ketë kujdes në këto:

1) nëse është prej atyre që kanë dëshirë t'i falënderojnë e të dëgjohet për ta, duhet të ngurrojë nga falënderimi, sepse plotësimi i të drejtës së tij është të mos i ndihmohet në zullum, ndërsa kërkimi i falënderimit është zullum;

2) nëse nga gjendja e vet e kupton se nuk dëshiron ta falënderojnë, por as nuk ikë prej tij, në atë rast duhet ta falënderojnë dhe të zbulojnë sadakanë e tij;

Për këtë arsye, kur filluan ta lavdërojnë një person në prani të Resulallahut, s.a.v.s., ai tha:

- E goditët në qafë! Po të dëgjonte ai lavdërimin tuaj, nuk do të gjente shpëtim.⁷²

ani pse edhe vet Resulallahu, s.a.v.s., i lavdëronte njerëzit në prani të tyre, i sigurt në *jekinin* e tyre dhe me dijen se kjo nuk do t'ju bëjë dëm atyre, përkundrazi, do t'i nxisë në vepra të mira; njërit prej tyre i tha se është zotëri (*sejjid*) i të gjithë beduinëve⁷³, e për një tjetër tha:

⁷² Muttefekun alejhi.

⁷³ Taberani

“Kur t’ju vijë dikush me nam nga popujt tjerë, gostiteni!”⁷⁴

Një herë dëgjoji disa fjalë që i lanë përshtypje, e tha:

- *Vërtetë në të folur ka joshje.*⁷⁵

Me një rast tjetër, Resulallahu, s.a.v.s., ka thënë:

“Kur dikush prej juve të sheh ndonjë vepër të mirë të vëllau, le ta njoftojë për këtë, sepse kjo do t’ia shtojë dëshirën për vepra të mira.”⁷⁶

Gjithashtu ka thënë:

“Kur e lavdërojnë besimtarin, atij i shtohet imani në zemër.”⁷⁷

Sufjan Sevri ka thënë: *“Atë që e njeh veten, nuk e dëmton lavdërimi i njerëzve”*, e Jusuf ibn Esbatit i tha:

- Kur ta bëj ndonjë të mirë ty, unë i gëzohem kësaj më shumë se ti, dhe nëse këtë unë e shoh si një nimet nga Allahu Teala, edhe ti m’u falëndero, e nëse nuk e shoh si nimet të Allahut, as ti mos m’u falëndero.

⁷⁴ Ibn Maxhe nga Ibn Omeri.

⁷⁵ Buhari.

⁷⁶ Dreikutni dhe Ibn Musejjeb.

⁷⁷ Taberani nga Usame b. Zejdi.

Hollësitë e këtyre kuptimeve do të duhej t'i shqyrtojë mirë ai që kujdeset për zemrën e vet. Ata që bëjnë ibadet vetëm me trup e pa i respektuar këto hollësira, për shkak të mundimit të panevojshëm nuk mundën të përparojnë, dhe bëhen arëgtim për shejtanin.

Ja, për këso lloj diturie është thënë: *“Prej kësaj të mësohet diçka, është më e vlefshme se ibadeti i një viti”*, sepse me këtë dituri ibadeti jeton gjatë, e me mosnjohje të saj, veprimi i vdes dhe i bëhet shterp.

Shkurtimisht, mënyra më e sigurt dhe më e mirë është pranimi i sadakasë haptas dhe dhënia e saj fshehtas. E të stoliset sadakaja me dhënie të saj haptas nuk është mirë. Për ata që kanë arritë përkryrjen është rast i vecantë, ku si dhënia haptas, si fshehtas, te ata kanë vlerë të njëjtë. Por të tillët janë pak. Për këtë shkallë flasin shumë, por ngritje në të nuk ka. Nga Allahu Teala kërkojmë ndihmë.

A ËSHTË MË MIRË TË MERRET SADAKAJA, APO ZEKATI?

Ibrahim Havass, Xhunejdi dhe një grup dijetarësh, konsideronin se më mirë është të pranohet sadakaja, se sa zekati, sepse marrja e zekatit ia vështirëson gjendjen më shumë fukarasë. Gjithashtu, është e mundur që pranuesi të mos e meritojë zekatin, siç është përshkruar në Kur'ani Kerim. E te sadakaja, çështja është fleksibile.

Disa të tjerë e preferuan zekatin, pasi që ai që e merr zekatin e ndihmon atë që po e jep që ta zbatojë këtë farz. Bile, nëse të gjithë fukaratë vendosin unanimitisht të mos e pranojnë zekatin, të gjithë janë gjynahqarë, sepse një prej kushteve për zbatimin e farzit është edhe dhënia e zekatit, e për dhënie të zeqatit, kusht është fukaraja. Zekatin e ka urdhëruar Allahu Teala, si furnizim për robët e Tij që kanë nevojë, prandaj ai që e pranon zekatin nuk duhet ta llogarisë veten si borxhli. Zekati merret sipas nevojës; personi e njuh veten se a ka nevojë apo jo, dhe sipas kësaj vendos se a e pranon apo jo zekatin. Por në marrje të sadakasë nuk është kështu; nganjëherë sadakanë e pranon edhe personi që është i njohur si fetar, sepse ai që jep sadakanë më parë zgjedh të devotshmin se sa fukaranë. Hyrja në mesin e fukarave është më afër modestisë, e mbrojtja nga mendjemadhësia, më larg fodullëkut.

Njeriu nganjëherë e pranon sadakanë edhe si një lloj të dhuratës, e në atë rast mund të mos llogaritet fukara, por marrja e zekatit megjithatë është dëshmi e mjerimit dhe varfërisë.

E drejta në këtë çështje është se parapëlqimi ndryshon sipas gjendjes së personit dhe nijetit. Nëse dyshon që nuk meriton zekat nuk duhet ta marrë atë, por nëse me siguri e di se e meriton, si për shembull nëse merr borxh për ndonjë punë të hajrit, e assesi nuk mundet që ta kthejë atë borxh, atëherë ai është plotësisht meritator për të pranuar zekatin. Nëse të këtillit i ofrohet të zgjedhë mes zekatit dhe sadakasë, dhe ai që e jep sadakanë nuk ia jep askujt pos tij, në atë rast zgjedh sadakanë, derisa ai që është i obliguar të japë zekatin, ia jep zekatin të varfrit.

Në gjithë këtë ka shtim të hajrit për të pasurin dhe sigurim të kushteve më të mira për të varfërit. Nga ana tjetër, nëse një pronë e caktuar do të destinohet për sadaka, e me pranim të zekatit nuk do të shkaktohej kurrfarë parehatie për të varfërin, atëherë mund të zgjedhë; nëse dëshiron zgjedhë sadakanë e nëse dëshiron zekatin. Argumentet, edhe të njërit edhe të tjetrit, dallojnë. Pranimi i zekatit e thyen nefsën dhe e nënçmon në të shumtën e rasteve, e Allahu e di më së miri.

Hamd i takon vetëm Allahut, Rabbit të botëve! Shumë salat dhe selam i qoftë përherë, deri në ditën e kiametit, zotërisë tonë, Muhammedit, a.s., të gjithë pejgamberëve, të gjithë melekëve në tokë dhe në qiej, ehli bejtit të Muhammedit s.a.v.s., dhe as'habëve të tij! Hamd Allahut, Neve na mjafton Allahu, Ai është mbrojtësi më i mirë!

PËRMBAJTJA

LLOJET E ZEKATIT	7
ZEKATI I BAGËTIVE	7
ZEKATI I NJË TË DHJETËS (PËR PEMË, PERIME DHE PRODUKTE BULQËSORE).....	12
ZEKATI NË ARI DHE ARGJEND	13
ZEKATI PËR MALLRA TREGTIE.....	15
ZEKATI NË <i>RIKAZ</i>	16
SADKATUL-FITR.....	17
KUSHTET (SHARTET) E DHËNIES SË ZEKATIT SI DHE ADABI ZAHIR DHE BATIN I TYRE	19
CILËSITË E ATYRE QË E MERITOJNË ZEKATIN DHE DETYRAT E TYRE NË RASTIN E PRANIMIT	57
DETYRAT E ATIJ QË E PRANON ZEKATIN	65
PËR SADAKANË VULLNETARE, VLERËN E SAJ DHE EDEBI I PRANIMIT DHE DHËNIES SË SAJ	75
VLERAT E SADAKASË	75
FJALËT E TË MËDHENJVE TË ISLAMIT PËR RËNDËSINË E SADAKASË	79
SHPJEGIMI I DHËNIES SË ZEKATIT DHE SADAKASË FSHEHTAS DHE HAPTAS.....	82
A ËSHTË MË MIRË TË MERRET SADAKAJA, APO ZEKATI?	95

